



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.110

16 tetor

2006

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.9612 datë 21.9.2006	Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Italisë për realizimin e programit “Për ristrukturimin dhe fuqizimin e sistemit elektrik shqiptar për integrimin në sistemin e Ballkanit: fuqizimi i aftësive të transmetimit dhe përmirësimit të kontrollit”.....	4313
Ligj nr.9613 datë 21.9.2006	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e UNESCO-s “Për mbrojtjen dhe zhvillimin e larmisë së shprehjeve të kulturave”.....	4328
Ligj nr.9614 datë 21.9.2006	Për certifikatat elektronike të gjendjes gjyqësore.....	4341

LIGJ
Nr. 9612, datë 21.9.2006

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË ITALISË PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT “PËR RISTRUKTURIMIN DHE FUQIZIMIN E SISTEMIT ELEKTRIK SHQIPTAR PËR INTEGRIMIN NË SISTEMIN E BALLKANIT: FUQIZIMI I AFTËSIVE TË TRANSMETIMIT DHE PËRMIRËSIMIT TË KONTROLLIT””

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Italisë për realizimin e programit “Për rristrukturimin dhe fuqizimin e sistemit elektrik shqiptar për integrimin në sistemin e Ballkanit: fuqizimi i aftësive të transmetimit dhe përmirësimit të kontrollit””.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5061, datë 4.10.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

MARRËVESHJE

PËR REALIZIMIN E “PROGRAMIT PËR RISTRUKTURIMIN DHE FUQIZIMIN E SISTEMIT ELEKTRIK SHQIPTAR PËR INTEGRIMIN NË SISTEMIN E BALLKANIT: FUQIZIMI I AFTËSIVE TË TRANSMETIMIT DHE PËRMIRËSIMIT TË KONTROLLIT”

Ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në vijim e quajtur METE, nga njëra anë,
dhe

Qeverisë së Republikës së Italisë, përfaqësuar nga Ministrinë e Punëve të Jashtme, Drejtoria e Përgjithshme e Bashkëpunimit për Zhvillimin, në vijim të quajtura MPJI/DPBZH, nga ana tjetër,
duke qenë se në marrëveshjet dypalëshe të bashkëpunimit të lidhura gjatë Komisionit të Përbashkët të prillit 2002, është rënë dakord për disa ndërhyrje strukturore në mbështetje të sektorit elektrik, ndër të cilat një (i) Program Ndhimë Financiare për Blerjen e Energjisë Elektrike nga Italia (30 milionë euro kredi ndihmëse) dhe financimi i pjesshëm i (II) i Linjës së Ndërlidhjes me 400 kV Shqipëri-Mal i Zi dhe i nënstacioneve përkatëse (30 milionë euro kredi ndihmë);

duke njohur se në datën 4 prill 2002 Komiteti Drejtues i Drejtorisë së Përgjithshme për Bashkëpunimin për Zhvillim pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Italisë, në bazë të kërkesës së Qeverisë Shqiptare miratoi në favor të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhënien e një kredie ndihme prej 30 milionë euro për blerjen e energjisë elektrike nga Italia;

duke njohur se Palët kanë nënshkruar më datë 19 prill 2002 një marrëveshje për zbatimin e Programit të Ndhmës Financiare për Blerjen e Energjisë Elektrike nga Italia 30 milionë euro kredi ndihmëse);

duke pasur parasysh se Pala Shqiptare nuk e ka përdorur të gjithë shumën e kredisë ndihmë që i është dhënë për blerjen e energjisë elektrike që vjen nga Italia;

duke njohur se në datën 29 dhjetor 2003 Pala Shqiptare, duke mos përdorur të gjitha kreditë ndihmë të lartpërmendur, kërkoi të përdorte pjesën e mbetur, prej rreth 21,5 milionë euro, të kësaj kredie për financimin e realizimit të Qendrës së Dispeçerisë dhe Telekontrollit të dikur KESH (tani OST), duke paraqitur justifikimet përkatëse;

duke pasur parasysh se u përgatit në mënyrë të përbashkët një dokument projekti, ku u përcaktuan dhe detajuan investimet për realizimin e Qendrës së Dispeçerisë dhe Telekontrollit të OST-së dhe për ndërtimin e linjës 400 kV Elbasan 2-Tirana 2 dhe të nënstacioneve përkatëse, duke e quajtur atë program për ristrukturimin dhe fuqizimin e sistemit elektrik shqiptar për integrimin e tij në sistemin e Ballkanit: fuqizimi i aftësive të transmetimit dhe përmirësimit të kontrollit, duke përcaktuar një angazhim financiar prej jo më shumë se 51,5 milionë euro si kredi ndihme;

duke njohur se në datën 20 dhjetor 2003 Komiteti Drejtues për Bashkëpunim në Zhvillim u shpreh pozitivisht për përfundimin e nismës. Programi i Ndhmës Financiare për Blerjen e Energjisë Elektrike nga Italia (30 milionë euro kredi ndihme), duke autorizuar që shuma e mbetur prej rreth 21,5 milionë euro të përdoret për realizimin e “Qendrës së Dispeçerisë dhe Telekontrollit Shqiptar”;

duke njohur se në datën 20 dhjetor 2005 Komiteti Drejtues për Bashkëpunimin në Zhvillim u shpreh pozitivisht për financimin e Programit, përmes dhënies së një kredie ndihme prej jo më shumë se 51,5 milionë euro si kredi ndihme;

duke njohur se në datën 13 mars 2006, Pala Shqiptare e përfaqësuar nga Ministria e Financave i ka kthyer Artigiancassa S.p.A. shumën e mbetur pa përdorur të transhit prej 10 milionë euro të Programit të Ndhmës Financiare për Blerjen e Energjisë Elektrike nga Italia (30 milionë euro kredi ndihme), për një shumë prej 1.494.303 euro;

duke pasur parasysh se shuma e përgjithshme e mbetur e Programit të Ndhmës Financiare për Blerjen e Energjisë Elektrike nga Italia (30 milionë euro kredi ndihme), arrin në shumën prej 21.494.303 euro;

parashtruar gjithë sa më sipër:

të dyja Palët ranë dakord për sa vijon:

Neni 1

Qëllimi dhe palët në Marrëveshje

Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është të rregullojë angazhimet e ndërsjella të të dyja Palëve për zbatimin e saktë të Programit, duke iu referuar në veçanti mënyrës së lidhjes së kontratave, si dhe mënyrave të menaxhimit/përcaktimit/livritimit të fondeve të kredisë ndihme.

Kjo Marrëveshje përbëhet nga 15 nene dhe nga 3 anekset që vijnë, të cilat janë pjesë e tij përbërëse dhe thelbësore.

- SHTOJCA I - Përmbledhje e Programit
- SHTOJCA 2 - Strukturat e administrimit të Programit dhe udhëzime operative
- SHTOJCA 3 - Mënyra e zbatimit dhe e administrimit të kredisë ndihmë

Fjalët dhe akronimet e përmendura në tekst kanë këtë kuptim:

SHKURTIME

MARRËVESHJE - Kjo Marrëveshje mes Palëve për zbatimin e Programit.

MARRËVESHJET E ATHINËS - Memorandumi i Mirëkuptimit për Tregun Rajonal të Energjisë Elektrike për Europën Juglindore dhe Integrimi i tij në Tregun e Brendshëm të Komunitetit European.

AMBASADA E ITALISË - Ambasada italiane në Tiranë.

AT - Asistencë teknike e dhënë në kuadrin e Programit.

OST- Operatori i Sistemit Shqiptar të Transmetimit.

QDT - Qendra e Dispeçerisë dhe e Telekontrollit të OST-së.
MARRËVESHJE FINANCIARE - Marrëveshje ndërmjet Ministrisë së Financave Shqiptare dhe administruesit të Fondit Qarkullues Italian.
DHURUESI - Qeveria Italiane.
DHURATË - Fond i vënë në dispozicion nga Drejtoria e Përgjithshme e Bashkëpunimit në Zhvillim/DPBZH për realizimin e disa elementeve përbërëse të Programit.
AFQ - Administruesi i Fondit Qarkullues (Artgiacassa): Instituti Financiar Italian që administron, për llogari të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave Italiane, fondet e kredisë ndihmë të parashikuara në Marrëveshje.
KESH-Korporata Elektroenergjetike Shqiptare.
LINJA E KREDISË - Kjo kredi ndihmë e krijuar për financimin e veprimtarive të parashikuara në këtë PROGRAM dhe e rregulluar nga dispozitat e kësaj Marrëveshjeje.
PALËT - Ministria e Punëve të Jashtme Italiane-Drejtoria e Përgjithshme për Bashkëpunimin në Zhvillim dhe Qeveria e Republikës së Shqipërisë, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.
MPJI-DPBZH -Ministria e Punëve të Jashtme Italiane-Drejtoria e Përgjithshme për Bashkëpunimin në Zhvillim.
METE - Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.
MF-Ministria e Financave.
Marrëveshja e nënhuasë - Marrëveshja ndërmjet MF-së dhe OST-së për ripagimin e kësaj linje - kredie për realizimin e Programit.
PIU/NJZP-OST “Njësia e Zbatimit të Projektit”, e krijuar pranë OST-së për realizimin e programit dhe për administrimin e kontratave përkatëse.
PMU/NJAP-METE “Njësia e Administrimit të Projektit”, e krijuar pranë METE-s për administrimin e Programit të Ristrukturimit Teknik dhe Menaxhues të KESH-it dhe Fuqizimin e Sistemit Elektrik Shqiptar; që do të ketë detyra operative në disa faza të realizimit të këtij Programi.
PROGRAMI - Tërësia e ndërhyrjeve të parashikuara dhe përcaktuara në këtë Marrëveshje.
OST - Operatori Sistemit të Transmetimit, organizëm kombëtar që drejton nga pikëpamja teknike e tregtare rrjetin e tij të transmetimit, përmes QDT-së së tij dhe shkëmbimet e energjisë elektrike ndërmjet vendeve të ndryshme.
UCTFE/BKTEE-Union for the Coordination of Transmission of Electricity (UCTE)/Bashkimi për Koordinimin e Transmetimit të Energjisë Elektrike (BKTEE) e Zonës 2: Europa Juglindore. Organizëm i cili përfshin të ashtuquajturit OST të këtyre vendeve: Shqipëri, Bosnjë-Hercegovinë, Bullgari, Kroaci, Greqi, Rumanë, Serbi e Mali i Zi dhe Turqi.
NJTQ (UTC) - Njësia Teknike Qendrore e MPJI/DPBZH.
NJTV (UTL) -Njësia Teknike Vendore (Zyra e e Kooperacionit) e ambasadës italiane në Tiranë.

Neni 2

Objektivat e Programit

Programi synon:

a) të pajisë OST-në me Qendrën e re të Dispeçerisë dhe Telekontrollit.
h) të realizojë ndërtimin e linjës 400 kV Elbasan 2 — Tiranë 2 dhe të nënstacioneve përkatëse. Qëllimi i Programit është të bëjë të mundur integrimin e sektorit elektrik shqiptar në tregun e rajonit të Ballkanit në zbatim të marrëveshjeve të Athinës.

Kjo gjë do të shpjerë në përmirësimin e sigurisë dhe të vazhdimësisë së shërbimit elektrik, do të bëjë të mundur rritjen e standardit të jetesës për popullin shqiptar dhe furnizimin me energji elektrike për sistemin prodhues, me qëllim që t'i vihet në ndihmë zhvillimit të sipërmarjes në vend dhe për rrjedhojë rritjes së investimeve private.

Neni 3
Përshkrimi i Programit

Në përputhje me objektivat e parashikuara në nenin 2, Programi, gjatë një periudhe të parashikuar prej 36 muajsh, synon të arrijë këto rezultate:

- të pajisë OST-në me Qendrën e Dispečerisë dhe të Telekontrollit (QDT), element kryesor ky për një menaxhim të rregullt dhe më ekonomik të sistemit të tij elektrik;
- t'i japë mundësi OST-së të bëjë pjesë zyrtarisht në tregun elektrik të rajonit, si anëtar efektiv i "Bashkimit për Koordinimin e Transmetimit të Energjisë Elektrike" (UTCE) të zonës 2: Europa Juglindore;
- të përmirësojë sigurinë e shërbimit elektrik në vend.

Për realizimin e Programit janë të nevojshme këto veprimtari (të cilat janë përshkruar më hollësisht në shtojcën 1):

- furnizimi dhe instalimi, në selinë e re dhe në nënstacionet ekzistuese, të aparaturave në përbërje të Qendrës së re të Dispečerisë dhe Telekontrollit (QDT) të Operatorit të Sistemit të Transmetimit OST);

- ndërtimi i selisë së re të QDT-së dhe OST-së;
- ndërtimi i nënstacionit 400/220 kV Tirana 2 dhe zgjerimi i nënstacionit ekzistues Elbasan 2;

- ndërtimi i linjës 400 kV Elbasan 2 — Tirana 1.

Neni 4
Institucionet e përfshira në realizimin e Programit

Institucionet e përfshira në realizimin e Programit janë si vijon:

Për Palën Shqiptare:

a) Ministria e Ekonomisë, e Tregtisë dhe Energjetikës Shqiptare (METE) do të garantojë zbatimin e detyrimeve të kësaj Marrëveshjeje, duke përfshirë, nëse do jetë e nevojshme, strukturat e tjera qeveritare shqiptare kompetente. METE, së bashku me PMU/METE do të sigurojë zhvillimin e një pjese të garave të parashikuara në këtë Program, me qëllim që të sigurohet tërësia e administrimit dhe e realizimit të disa impianteve që bëjnë pjesë në disa objekte të tjera; të cilat po realizohen në kuadër të linjës së kredisë së mëparshme për sektorin elektrik. METE do të sigurojë gjithashtu edhe monitorimin e Programit, sikurse është treguar në anekset e kësaj Marrëveshjeje;

b) Ministria e Financave Shqiptare (MFSH) që do të nënshkruajë Marrëveshjen Financiare me AFQ-në dhe që do të kujdeset për kontaktet operative me këtë të fundit, sipas sa është saktësuar në vetë Marrëveshjen Financiare, dhe që do të lidhë një marrëveshje nënshkruar me OST-në;

c) OST që, nëpërmjet krijimit të një njësie të posaçme të zbatimit të projektit (PIU/NJZP-OST) do të veprojë në cilësinë e Agjencisë së Zbatimit të Programit.

Për Palën Italiane:

a) Qeveria Italiane, e cila do të garantojë livrimin e burimeve financiare të kredisë, sipas mënyrave të parashikuara nga legjislacioni italian në fuqi, përmbljedhtasi të treguara në këtë Marrëveshje MPJI/DPBZH do të veprojë përmes zyrave kompetente për kryerjen e detyrave të veta;

b) Administruesi i Fondit Qarkullues (AFQ), që sipas udhëzimeve të MPJI/DPBZH dhe Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave të Italisë do të nënshkruajë me Ministrinë e Financave Shqiptare një marrëveshje financiare që do të rregullojë përdorimin e fondeve si kredi ndihme; Në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje Financiare, AFQ-ja do të kujdeset për lidhjen e kontratave të veçanta për livrimin e mallrave, shërbimeve dhe punimeve, përmes të cilave do të realizohen veprimtaritë e parashikuara në Program. AFQ do të kujdeset gjithashtu për të siguruar pagesën e shumave të kontratës për organizmat zbatues.

c) Ambasada /NJTV në Tiranë do të sigurojë të gjitha funksionet me karakter teknik të nevojshme për një supervizion të rregullt të ecurisë së punimeve.

Neni 5

Burime financiare dhe mënyra të përdorimit të kredisë ndihmë

Burimet financiare të nevojshme për realizimin e Programit, sikurse më mirë është treguar në shtojcën 1, janë si vijon:

1. Kredia ndihmë prej 51 500 000,00 euro për realizimin e të gjitha veprimtarive të përshkruara në Program.

2. Fonde të OST-së, të barazvlefshme me rreth 6000 000 euro, për kostot vendore (taksa, shpenzime doganore etj).

3. Dhuratë prej 145 000,00 euro e Qeverisë Italiane për krijimin e një fondi pranë ambasadës italiane/NJTV në mbështetje të PIU/OST-së.

4. Dhuratë prej 180 000,00 euro në dispozicion të MPJI/DPBZH-së për veprimtari asistence për kundërpalët shqiptare dhe për supervizionin dhe monitorimin e Programit.

Në bazë të procedurave në fuqi për MPJI/DPBZH, hapat kryesore që duhen ndjekur për përdorimin e fondeve të kredisë së ndihmës, janë si më poshtë:

1. Nënshkrimi i kësaj Marrëveshjeje.

2. Nxjerrja, nga ana e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave të Italisë, e një dekreti ministror që autorizon AFQ-në të negociojë dhe nënshkruajë Marrëveshjen Financiare me MFSH-në;

3. Miratimi nga ana e MPJI/DPBZH-së i planit të prokurimit, përgatitur nga PIU-OST, sipas sa është saktësuar në shtojcën 3. Në këtë plan prokurimi do të tregohen, përveçse garave dhe ndarjes në lote të ndryshme, edhe strukturat shqiptare të ngarkuara për administrimin përkatës (PUT/OST) ose PMU/MECE sipas nenit paraardhës, 4 pika a dhe c).

4. Lidhja e Marrëveshjes Financiare ndërmjet AFQ-së dhe MFSH-së.

5. Shpallja e garave të parashikuara në planin e prokurimit, shpallja e fituesve të garave dhe përfshirja e kontratave në Marrëveshjen Financiare dhe administrimi i tyre sipas procedurave të treguara në shtojcën 3.

Neni 6

Monitorimi i Programit

Ecuria e Programit do të monitorohet në mënyrë periodike dhe të përbashkët nga MPJI/DPBZH dhe METE.

Ky monitorim do të kryhet nga MPJI/DPBZH përmes misioneve periodike të funksionarëve ekspertë, që do të caktohen sipas nevojës. Të dyja Palët angazhohen të përcaktojnë së bashku dhe të zbatojnë të gjitha masat që do t'i konsiderojnë të nevojshme për arritjen e objektivave të Programit, sikurse tregohet në nenin 2.

Neni 7

Mënyrat për përfitimin e shërbimeve, furnizimeve dhe punimeve

Realizimi i veprimtarive të Programit, do të kryhet përmes garave të cilat do të zhvillohen në përputhje me dispozitat e Manualit të Procedurave (e miratuar nga Komisioni European më 23 dhjetor 2002) dhe ndryshime të mundshme të mëpasme, me përjashtim të pjesës që ka të bëjë me rregullat mbi kombësinë dhe origjinën, e cila do të përshtatet ndaj veçantisë të kredisë së ndihmës italiane, në lidhje me: “Kontraktim shërbimesh, furnizim mallrash dhe punimesh në kuadrin e bashkëpunimit komunikuar me vendet e treta” dhe sipas sa është saktësuar në shtojcën 2 dhe 3.

Neni 8

Detyrime të Qeverisë Italiane

Qeveria italiane angazhohet:

- a) të garantojë financimin prej 51 500. 000, 00 euro të kredisë ndihmë;
- b) të garantojë financimin prej 145 000, 00 euro si dhuratë në ndihmë të PIU/OST;
- c) të garantojë financimin prej 180 000, 00 euro si dhuratë për veprimtaritë e supervizionimit dhe monitorimit.

Kredia ndihmë do të livrohet në kushte financiare të tilla që duhet të parashikojnë një përqindje interesi (grant element) të paktën jo më të ulët se 80%.

Afatet dhe kushtet e kredisë ndihmë do të jenë:

- kohëzgjatja 39 vjet;
- përqindja e interesit 0.00%
- periudha pa pagesë principali 19 vjet.

Fondi i kredisë ndihmë do të jetë i disponueshëm pranë AFQ-së dhe do të livrohet sipas procedurave të parashikuara në Marrëveshjen Financiare dhe në përputhje me sa është përcaktuar në shtojcën 3.

Fondi dhuratë prej 145 000, 00 do të livrohet në këste vjetore pas kërkesës së ambasadës/NJTV;

Fondi dhuratë prej 180 000, 00 euro do të jetë në dispozicion të MPJI/DPBZH, për të dërguar misione afatshkurtra në Shqipëri apo për të përfutur shërbime *ad hoc*, në kuadrin e veprimtarive të supervizionimit dhe monitorimit të përbashkët të Programit.

Neni 9

Detyrime të Qeverisë Shqiptare

Qeveria Shqiptare angazhohet:

1. të kalojë, përmes një marrëveshjeje nënshkruar me OST-në kredinë ndihmë me kushtet e mëposhtme:

- kohëzgjatja e kredisë 39 vjet;
- periudha pa pagesë principali 19 vjet;
- përqindje e interesit nominal 2% me bazë vjetore.

2. të garantojë që OST të vërë në dispozicion burimet financiare që i takojnë asaj, të barazvlefshme me rreth 6 000 000 euro më mirë specifikuar në shtojcën 1;

3. t'i bëjë operative të gjitha veprimet, veprimtaritë dhe aktet zyrtare të domosdoshme për realizimin e Programit, të treguara në shtojcën 1;

4. të bashkëpunojë me MPJI/DPBZH për monitorimin e Programit, sipas nenit 6 dhe përsa i përket aksesit në dokumente dhe në hapësirat e veprimtare.

Neni 10

Dispozita antikorrupsion

Qeveria e Republikës së Italisë është angazhuar në luftën kundër korrupsionit në të gjitha format e tij. Në mënyrë të veçantë, me qëllim që të shmanget çdo mundësi veprimi i paligjshëm dhe parregullsi gjatë paraqitjes së ofertave për furnizim mallrash, shërbimesh dhe punime civile, Qeveria Italiane ka parashikuar për të gjithë pjesëmarrësit në gara detyrimin për të nënshkruar dhe paraqitur krahas me ofertat e tyre apo me kontratat e miratuara, edhe shtojcën Integrity Pact. Mosparaqitja e dokumentacionit të mësipërm do të përbëjë përjashtimin e menjëhershëm nga gara apo arsye për të zbatuar sanksionet e rënda të Integrity Pact në rast mosrespektimi të angazhimeve antikorrupsion gjatë zbatimit të kontratës. Përfshirja e kësaj klauzole synon të sigurojë një konkurrencë të rregullt dhe mundësi të barabarta për të gjithë pjesëmarrësit, si dhe një zbatim të rregullt dhe transparent të kontratës së miratuar.

I takon Qeverisë Italiane që me kujdesin më të madh të kontrollojë përdorimin e Integrity Pact si në lidhje me pjesëmarrësit, ashtu dhe në lidhje me personelin, bashkëpunëtorët dhe konsulentët.

Neni 11
Mosmarrëveshje

Nëse gjatë realizimit të Programit do të lindin mosmarrëveshje në lidhje me interpretimin apo zbatimin e saj, për sa të jetë e mundur, ato duhet të zgjidhen përmes këshillimit dhe negocimit.

Neni 12
Pengesa dhe forca madhore

Në rast pengese për realizimin e Programit, për shkaqe të forcës madhore (luftë, përmytje, zjarr, tufan, tërmet, konflikte në punë, greva, masa të qeverive përkatëse, vështirësi të paparashikuara në transport dhe shkaqe të tjera) të pranuar nga të dyja Palët, apo në rast rreziku apo kushtesh të rrezikshme për personelin e ardhur nga jashtë vendit, do të merren vendimet e mëposhtme, në bazë të rekomandimeve të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe të miratuara nga MPJI/DPBZH:

a) Nëse kohëzgjatja e pengesës për realizimin e Programit është më e vogël se gjashtë muaj, përdorimi i fondeve të papërdorura ndërpritet deri sa MPJI/DPBZH të autorizojë rifillimin e veprimtarive.

b) Nëse kohëzgjatja e pengesës është më e madhe se gjashtë muaj dhe më e vogël se njëzet e katër, programi ndërpritet dhe fondet e papërdorura ruhen deri sa të mos ekzistojë më pengesa dhe të merret autorizimi i MPJI/DPBZH për të rifilluar veprimtarinë.

c) Nëse kohëzgjatja e pengesës është më e madhe se njëzet e katër muaj, Palët do të bëjnë çdo përpjekje që të bien dakord për vazhdimësinë e Programit dhe të përcaktojë radhën e veprimeve. Në rast pamundësie për të vazhduar veprimtaritë, Palët duhet të vendosin për përdorimin e fondeve të papërdorura.

Në rast pengese apo force madhore në lidhje me projekte dhe/ose veprimtari, veprimtaritë dhe fondet përkatëse pezullohen deri në zgjidhjen e pengesave dhe në autorizimin për të rifilluar, i cili jepet nga Pala përkatëse. Nëse pengesat vazhdojnë të jenë për më shumë se njëzet e katër muaj, Palët janë të detyruara të përcaktojnë destinacionin e fondeve të mbetura. Veprimtaritë e projekteve që nuk janë vënë në vështirësi nga pengesat mund të vazhdojnë deri në përfundim të tyre dhe fondet e caktuara për to mbeten të disponueshme.

Neni 13
E drejta e zgjidhjes së marrëveshjes nga MPJI/DPBZH

MPJI/DPBZH ruan të drejtën të heqë dorë nga Mosmarrëveshja në këto raste:

a) mosrealizim i veprimtarive të parashikuara në Program;

b) pengesë e zgjatur në kohë apo forcë madhore në bazë të nenit 12.

Në rastet e sipërpërmendura, MPJI/DPBZH mund të vendosë në mënyrë të njëanshme përfundimin e Marrëveshjes, duke njoftuar METE-n dhe OST-në përmes një note verbale të paktën tre muaj para. Sidoqoftë, pas një njoftimi të tillë, OST është e detyruar të ndërprerë veprimtaritë e Programit, me përjashtim të rastit kur Palët bien dakord ndryshe.

Neni 14
Ndryshimet

Palët mund të propozojnë në çdo kohë ndryshime të kësaj Marrëveshjeje përmes shkëmbimit të notave, nëpërmjet kanaleve diplomatike. Ndryshimet për të cilat bien dakord në këtë mënyrë, do të hyjnë në fuqi duke ndjekur të njëjtat procedura të parashikuara nga Marrëveshja për hyrjen e saj në fuqi.

Hyrja në fuqi dhe kohëzgjatja

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e marrjes së njoftimit të dytë, nga të dyja njoftimet, me anë të të cilave Palët Kontraktuese do të njoftojnë zyrtarisht kryerjen e procedurave të brendshme e ratifikuese përkatëse, parashikuar sipas nevojës.

Kjo Marrëveshje ka një kohëzgjatje prej tre vjetësh, duke filluar nga hyrja e saj në fuqi. Nëse, në përfundim të afatit trevjeçar, veprimtaritë e Programit nuk do të kishin përfunduar, Palët, duke shkëmbyer nota me shkrim, do mund të bien dakord për një shtyrje të afatit të vlefshmërisë së kësaj Marrëveshjeje për periudha të mëtejshme kohore, të cilat duhet të përcaktohen përmes vullnetit të Palëve, por që kufizohen me përdorimin e shumave të mbetura të parashikuara në të.

Kjo Marrëveshje do mund të denoncohet në çdo kohë dhe nëse do të vërtetoheshin situata e kushte siç janë parashikuar nga neni 12. Denoncimi do të ketë vlerë deri në 60 ditë pas kryerjes së njoftimit të Pala Kontraktuese.

U shkrua në Tiranë, më ___ / ___ / _____ në dy origjinalë, secili në gjuhën italiane dhe shqipe. Në rast shtrembërimi të interpretimit, do të ketë vlerë teksti në gjuhën italiane.

Në mbështetje të sa më sipër paraqitur, të nënshkruarit, përfaqësuesit, rregullisht të autorizuar nga qeveritë përkatëse, nënshkruan këtë Marrëveshje.

PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
MINISTRI I EKONOMISË TREGTISË
DHE ENERGJETIKËS

Genc Ruli

PËR QEVERINË E REPUBLIKËS
ITALIANE
AMBASADORI ITALIAN NË TIRANË

Attilio Massimo Jannucci

SHTOJCA 1

PROGRAM PËR RISTRUKTURIMIN DHE FUQIZIMIN E SISTEMIT ELEKTRIK SHQIPTAR PËR INTEGRIMIN E TIJ NË SISTEMIN E BALLKANIT: FUQIZIM I AFTËSIVE TË TRANSMETIMIT DHE PËRMIRËSIMIT TË KONTROLLIT

Duke vazhduar më tej në bashkëpunimin e krijuar në sektorin elektrik që nga viti 1992, i cili shpuri në kryerjen e investimeve për një shumë rreth 65 milionë euro, nga të cilat rreth 5.5 milionë dhuratë, MPJI/DPBZH ka pranuar kërkesën e Qeverisë Shqiptare për të përdorur pjesën e mbetur (21.5 milionë euro) të kredisë së ndihmës së dhënë në prill 2002, për blerjen e energjisë elektrike, për financimin e Qendrës së Re të Dispeçerisë dhe për të dhënë një kredi ndihme prej 30 milionë euro për financimin e linjës 400 kV Elbasan 2- Tirana 2 dhe të seksionit 400/220 kV të nënstacionit përkatës.

Përmbajtja e këtij Programi pasqyron gjithë sa përgatitur në dokumentin e projektit, fryt i punës së përbashkët me kundërpalën shqiptare, dhe tregon në hollësi punimet, shërbimet dhe furnizimet e nevojshme për realizimin e tij.

Përmes këtij Programi, i cili integrohet me programet e donatorëve të tjerë (Banka Botërore, Banka Europiane e Investimeve, Banka Europiane për Rindërtim e Zhvillim, Japonia, Zvicra, Spanja dhe Norvegjia) do të bëhet i mundur integrimi i vendit në tregun elektrik rajonal.

Objektivi i Programit

Përmirësimi i besueshmërisë së shërbimit elektrik do të ndihmojë në rritjen e nivelit të jetesës së popullsisë, si dhe në investimet e reja me kapital të huaj në vend. Më në veçanti synon:

- të pajisë OST-në me mjetet e domosdoshme për një menaxhim të rregullt dhe ekonomik të sistemit të vet elektrik dhe ta fusë Shqipërinë në tregun elektrik europian, duke ndihmuar hyrjen e saj zyrtare në "Bashkimin për Koordinimin e Transmetimit të Energjisë Elektrike" (UTCE) të Zonës 2; Europa Juglindore.

Organizmi që bashkon të ashtuquajturit “Transmission System Operators” të këtyre vendeve: Shqipëri, Bosnjë, Hercegovinë, Bullgari, Kroaci, Greqi, Rumani, Serbi dhe Mali i Zi e Turqi.

Rezultatet e pritshme

Me qëllim që të arrihet objektivi specifik i treguar më sipër, është parashikuar që brenda periudhës kohore trevjeçare të programit të arrihen këto rezultate:

1. Racionalizimi i ndërshkëmbimit të energjisë me vendet e rajonit.
2. Përmirësimi i sigurisë së shërbimit elektrik me uljen për rrjedhojë të humbjeve teknike.

Veprimtari që synojnë arritjen e rezultateve

Për secilën prej rezultateve të sipërtreguara, parashikohet të realizohen këto veprimtari:

a) Shërbime inxhinierike për asistencë teknike për OST-në për zhvillimin e garave dhe realizimin e projekteve.

b) Krijimi i një ndërtese të re për të vendosur në të Qendrën e Dispečerisë dhe Telekontrollit (QDT) dhe selinë e OST-së.

c) Furnizimi dhe montimi i sistemeve për QDT-në.

d) Zëvendësim i disa aparaturave të manovrimit, mbrojtjes dhe matjes së nënstacioneve të përfshira në kontrollin nga QDT.

e) Implementimi dhe modernizimi i sistemit të telekomunikimit.

f) Ndërtimi i nënstacionit të ri 400/220 kV Tirana 2.

g) Zgjerimi i nënstacionit ekzistues Elbasan 2.

h) Ndërtimi i linjës 400 kV ndërmjet nënstacioneve Elbasan 2 dhe Tirana 2 (rreth 48 km).

Programi parashikon gjithashtu një sërë masash të nevojshme për të garantuar administrimin e rregullt të tij:

a) Do të krijohet një “Njësi Zbatimi të Projektit”, PIU/OST pranë OST-së që do të përfitojë një ndihmë teknike dhe financiare nga ana e MPJI/DPBZH;

b) MPJI/DPBZH do të sigurojë të gjitha burimet e nevojshme për monitorimin e Programit;

c) OST do të sigurojë të gjitha burimet financiare për mbulimin e kostove lokale (punime civile, taksa shpenzime doganore etj).

Qeveria Shqiptare angazhohet të zbatojë për realizimin e këtij Programi këto veprime:

1. Të plotësojë kushtet e treguara në tabelën e mëposhtme.

2. Të realizojë, sipas afateve të treguara në tabelën e përmendur, masat e domosdoshme për arritjen e rezultateve.

3. Të plotësojë, përpara nënshkrimit të marrëveshjes financiare, procesin e mbylljes administrative të ndërhyrjes për blerjen e energjisë elektrike nga Italia, si vijon:

	Ideja e ndërhyrjes	Kushtet
Objektivi specifik	Përmirësim i aftësisë së menaxhimit të sistemit elektrik shqiptar, për integrimin e plotë të tij në tregun elektrik të Europës Juglindore	- Vazhdimësi e procesit të unbundling - Pavarësi në rritje operative dhe funksionale për OST - Vijimësi e politikës së tarifave
Rezultatet e pritshme	Racionalizim i ndërshkëmbimit të energjisë elektrike me vendet e rajonit. Përmirësimi i sigurisë së furnizimit me energji elektrike dhe ulje e humbjeve teknike	- Vijimësi e procesit të unbundling - Pavarësi në rritje operative dhe funksionale e OST (brenda gjysmës së vitit 2006)
Veprimtaritë	Realizimi i qendrës së re të dispečerisë dhe telekontrollit dhe ndërtimi i selisë së re të OST-së	Vënie në dispozicion e terrenit dhe e licencave përkatëse, përpara hapjes së garës
	Ndërtim i linjës 400 kV Elbasan-Tiranë	Dhënia e së drejtës së kalimit të linjës
	Ndërtimi i n/stacionit të ri 400/220 kV Tirana 2 dhe zgjerimi i n/stacionit ekzistues Elbasan 2	Vënie në dispozicion e terrenit dhe e licencave përkatëse para hapjes së garës

	Shërbime inxhinierike dhe supervizioni	Mirëtim i planit të prokurimit
	Administrimi i programit-ndihmë për PIU/OST	Krijimi i PIU pranë OST-së
	Administrimi i Programit të Monitorimit nga ana e DPBZH	Nënshkrimi i Marrëveshjes

Të dyja palët angazhohen të përcaktojnë së bashku dhe të zbatojnë të gjitha masat që do të gjykojnë të nevojshme të ndërmerren, nëse gjatë zbatimit të Programit do të rezultonte e pamundur përmbushja e kushteve të mësipërme.

Tabela 1
Skema financiare e programit

Veprimtaria	Përshkrimi	Kredi ndihmë €	Dhuratë €	Fin.lokal €	Total €
Realizim i qendrës së dispeçerisë dhe telekontrollit	Furnizime dhe montime	17 500 000, 00	0	0	17 500 000,00
Ndërtim i një selie të re për qendrën e dispeçerisë dhe OST-së	Furnizime dhe punime	4 000 000, 00	0	1 000 000, 00	5 000 000, 00
Ndërtim i linjës 400 kV Elbasan 2-Tirana 2	Furnizime, punime civile dhe montime	8 500 000, 00	0	0	8 500 000, 00
Ndërtimi i n/stacionit Tirana 2 (400 kV)	Furnizime, punime civile dhe montime	19 200 000, 00	0	1 000 000, 00	20 200 000,00
Zgjerimi i n/stacionit ekzistues Elbasan 2 (400 kV)	Furnizime punime civile dhe montime	1 500 000, 00			1 500 000, 00
Supervizion i punimeve dhe shërbimeve të inxhinierisë	Shërbime	800 000, 00	0	0	800 000, 00
Administrim i Programit – ndihmë për PIU/OST	Fond falas për furnizime, blerje dhe shërbime të vogla	0	145 000, 00	0	145 000, 00
Administrim i Programit – sipervizion e monitorim	Fondi i ekspertëve		180 000, 00		180 000, 00
Shpenzime doganore	Shpenzime doganore/tatime vendore	0	0	4 000 000, 00	4 000 000, 00
	Totali	51 500 000, 00	325 000, 00	6 000 000, 00	57 825 000,00

Kontributi i Qeverisë Italiane do të jetë:

- Kredi ndihme	51 494 303, 00 euro
- Dhuratë	325 000, 00 euro
Total	51 819 303, 00 euro
Kontributi i OST do të jetë:	6 000 000, 00 euro
Kosto e përgjithshme e nismës rezulton e barasvlefshme me 57 819 303,00 euro	

SHTOJCA 2

STRUKTURAT E ADMINISTRIMIT TË PROGRAMIT DHE UDHËZIME OPERATIVE

1. Strukturat e administrimit

Strukturat e administrimit të këtij Programi tregohen në tabelën e mëposhtme:

Organizimi	Përshkrimi, përbërja	Detyrat/përgjegjësitë
MPJI/DPBZH	Ministria e Punëve të Jashtme Italiane - Drejtoria e Përgjithshme për Bashkëpunim në Zhvillim	- Nënshkruan Marrëveshjen e Programit. - Monitoron ecurinë e Programit, duke sugjeruar dhe ndërhyrë kur është e nevojshme, për të bërë ndërhyrje korrigjuese; - Siguron disponibilitetin e burimeve të dhuruara (Fondi i ekspertëve dhe fonde vendore); - Siguron praninë e ekspertëve dhe specialistëve për fillimin dhe monitorimin e Programit; - Lëshon të gjitha autorizimet e nevojshme gjatë realizimit të programit, në lidhje me elementin e financuar si kredi ndihme (Shtojca 3); - Kontrollon veprimet e përcaktuara për linjën e kredisë.
Ambasada/NJTV		- Merr pjesë në supervizionimin e Programit, së bashku me METE duke i sugjeruar MPJI-DPBZH ndryshimet dhe plotësimet që i gjykon të nevojshme.
AFQ (Artigiancassa)	Banka Italiane e ngarkuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave Italiane për të nënshkruar Marrëveshjen Financiare me MFSH	Kujdeset në kuadrin e Marrëveshjes Financiare për përfshirjen në linjën e kredisë e kontratave të veçanta për livrimin e mallrave, shërbimeve dhe punimeve, përmes të cilave do të realizohen veprimtaritë e parashikuara në Program. - Siguron pagesën e shumave të kontratave për organizmat realizues, të përzgjedhur pas tenderave.
MFSH	Ministria e Financave Shqiptare	- Nënshkruan Marrëveshjen financiare me AFQ-në; - Siguron kontaktet me AFQ-në; - I kthen kredinë AFQ-së sipas kushteve të vendosura në Marrëveshjen financiare.

		- Nënshkruan me OST-në një marrëveshje të veçantë nën huaje.
METE	Ministria e Ekonomisë Tregtisë dhe Energjetikës	- Nënshkruan këtë Marrëveshje; - Ndjek për Palën Shqiptare supervizionin e Programit. - duke përfshirë, kur është e nevojshme, strukturat qeveritare.
PMU-METE	Njësia e Administrimit të Projektit, e krijuar në kuadrin e Programit të Ristrukturimit Teknik dhe Menaxhues të KESH-it dhe fuqizimit të sistemit elektrik shqiptar, vepron nën juridiksionin e METE	- Do të sigurojë zhvillimin e garave të parashikuara në planin - e prokurimit të propozuar me OST-në dhe miratuar nga MPJI-DPBZH, sikurse është përcaktuar në nenin 5 të Marrëveshjes; - Do të asistojë METE në supervizionin e ecurisë së veprimtarive.
OST	Operatori i Sistemit të Transmetimit	- Do të kërkojë miratimin e Planit të Prokurimit, në lidhje me garat sipas të cilit do të shtrihet Programi. - Miraton të gjitha dokumentet e garave. - Do të shpallë garat, sipas asaj që përcaktohet në nenin 4 të kësaj Marrëveshjeje. - Do të caktojë funksionarët e vet si anëtarë të komisioneve të vlerësimit. - Do të bëjë nënshkrimin e kontratave me shoqëritë, që do të shpallen fituese të garave në kompetencë të saj pas marrjes së miratimit nga MPJI/DPBZH. - Do të autorizojë pagesat. - Do të supervizionojë zbatimin e kontratave (me asistencën e një shoqërie konsulence). - Do të procedojë me kolaudimet (me asistencën e një shoqërie konsulence).
PIU-OST	Njësia e zbatimit të projektit, e krijuar për realizimin e këtij Programi, që do të veprojë nën juridiksionin e OST.	- Do të përgatitë planin e prokurimit të gjithë Programit (me ndihmën e misioneve të DPBZH). - Do të kontrollojë dokumentacionin e garave, të përgatitur nga Shoqëria e Konsulencës, për realizimin e të gjitha shërbimeve, mallrave dhe punimeve të parashikuara në Program. - Do të asistojë komisionet e vlerësimit të ofertave. - Do të kontrollojë hartimin e projekteve të kontraktorëve në rishikimin dhe miratimin e materialeve përkatëse. - Do të inspektojë materialet pas mbërritjes së tyre në destinacion. - Do të supervizojë realizimin e punimeve civile e të montimeve. - Do të kontrollojë provat dhe vënien në punë të pajisjeve.

		<ul style="list-style-type: none"> - Kontrollon funksionimin e rregullt të aparaturave dhe përputhshmërinë teknike të punës së tyre. - Do të asistojë OST në administrimin dhe miratimin e pagesave në respektim të afateve të kontratave. - Do të asistojë OST në administrimin dhe miratimin e pagesave në respektim të afateve të kontratave. - Do të asistojë OST në kontrollin e plotësimit të afateve të programit për realizimin e punimeve. - Do të asistojë OST në kontrollin e zbatimit të normave të sigurimit teknik gjatë kryerjes së punimeve. - Do të asistojë OST në kontrollin e respektimit të normave për mjedisin.
--	--	--

PIU/OST do të mbështetet në asistencën teknike që do të japë MPJI/DPBZH, përmes misioneve afatshkurtëra dhe afatgjata të konsulentëve me përvojë specifike në këtë sektor:

- gjatë fazës fillestare të projektit: misione afatshkurtra me përvojë të veçantë në fushën specifike tekniko-kontraktore për asistencë në përgatitjen e planit të prokurimit dhe të dokumentacioneve të garës në lidhje me sigurimin e furnizimeve dhe të punimeve;

- gjatë fazës së realizimit: misione ekspertësh në sektorin elektrik, afatshkurtra dhe afatgjata, këto të fundit duke pasur parasysh rëndësinë dhe larminë e natyrës së ndërhyrjeve të parashikuara në program.

Personeli i ambasadës /NJTV dhe ai i shoqërive të kontraktuara nga PIU/OST për konsulencë teknike, nuk mund të marrë pjesë në komisionet e vlerësimit, detyrë kjo që i takon vetëm palës shqiptare.

PIU/OST do të mbështetet në personelin e mëposhtëm shqiptar, caktuar nga OST-ja dhe të pranuar nga ambasada /NJTV:

- një drejtor i diplomuar në inxhinieri elektrike;
- një sekretare, edhe me funksione administrative.

Ky personel duhet të njohë mirë gjuhën italiane. Me nisjen e Programit do të përcaktohen në hollësi “Detyrat e vendit të punës” për figurat e tregura më sipër.

2. Udhëzime operative

Ky aneks i referohet përdorimit të kredisë së ndihmës italiane.

Përcaktimi i kontratave do të bëhet përmes garave të hapura, ku mund të marrin pjesë shoqëritë italiane (me parakualifikim në rast garash për shërbime). Përqindja e kredisë së ndihmës që mund të përdoret për kosto lokale dhe/ose në vende të treta në kuadrin e çdo kontrate, në asnjë rast nuk mund të jetë më e lartë se 80% e vlerës së vetë kontratës. Përqindja e përgjithshme për shpenzimet lokale apo për blerje në vendet e treta sidoqoftë nuk mund të jetë më e lartë e 35% e shumës së gjithë kredisë ndihmë prej 51. 494. 303, 00 milionë euro.

Për zhvillimin e të gjitha garave të parashikuara në Program, do të ndiqen procedurat e parashikuara në manualin e procedurave (miratuar nga Komisioni Europian më 23 dhjetor 2002) dhe ndryshime të mundshme e të mëvonshme, në lidhje me kontraktim shërbimesh, furnizimesh dhe punimesh në kuadrin e bashkëpunimit komunitar me vendet e treta, me përjashtim të pjesës që, në zbatim të nenit 15 direktiva 2004/18/KE ka të bëjë me rregullat mbi kombësinë dhe origjinën, e cila do të përshtatet ndaj specificitetit të kredisë së ndihmës italiane.

Në çdo rast, procedura e përzgjedhjes duhet të përmbajë sidoqoftë:

1. Kontrollin e përshtatshmërisë së ofruesve (persona juridikë, shoqëri dhe ndërmarrje) që nuk do të konsiderohen të përshtatshëm nëse:

a) janë në gjendje falimentimi, likuidimi, administrimi nën kontroll apo marrëveshesh paraprake, ndërprerje aktiviteti apo që i janë nënshtruar një procedure të ngjashme të parashikuar nga ligjet dhe nga rregulloret kombëtare;

b) i janë nënshtruar një procedure shpalljeje falimentimi, likuidimi, administrimi nën kontroll apo marrëveshesh paraprake, ndërprerjeje aktiviteti apo që i janë nënshtruar një procedure të ngjashme të parashikuar nga ligjet dhe nga rregulloret kombëtare;

c) të kenë marrë një dënim të formës së prerë për një krim në lidhje me moralin profesional;

d) janë përgjegjës për shkelje të rënda të detyrave profesionale, të provuara me çdo element të dokumentueshëm nga administrata tenderuese;

e) nuk kanë shlyer rregullisht detyrimet në lidhje me sigurimet shoqërore sipas dispozitave ligjore të vendit ku ato janë vendosur;

f) nuk kanë shlyer rregullisht detyrimet në lidhje me tatimet e taksat sipas dispozitave ligjore të vendit ku janë vendosur;

g) janë fajtorë për pasaktësi të rënda në dhënien e informacioneve të kërkuara nga administrata tenderuese në lidhje me sa më sipër;

gj) janë shpallur fajtorë, për shkak të mosrespektimit të detyrimeve kontraktore, për mospërbushje të rënda në lidhje me zbatimin, në kuadrin e një kontrate tjetër të nënshkruar me po këtë administratë tenderuese apo në kuadrin e një kontrate tjetër të financuar përmes fondeve të Komunitetit Europian;

Gjithashtu, ofruesit italianë do jenë të detyruar të paraqesin një certifikatë apo një deklaratë të barasvlefshme, sipas së cilës nuk u përkasin kategorive të parashikura në dekretin legjislativ italian (8.08.1994, 490 antimafia).

Pjesëmarrësit në garë, në mbështetje të ofertave të tyre duhet të paraqesin provat e zakonshme, në përputhje me legjislacionin e vendit në të cilin janë të vendosur, e që vërtetojnë se ato nuk gjenden në asnjë prej kushteve e situatave të parashikuara në pikat (a), (b), (c), (e) dhe (f).

Kontrolli i gjendjes ekonomike dhe financiare të ofruesve, përmes:

a) një deklaratë të kapitalit shoqëror të shoqërisë dhe të xhiros në tre vjetët e fundit para zhvillimit të tenderit;

b) një deklaratë të xhiros së përgjithshme të konkurrentëve, dhe në rastin e një bashkimi të përkohshëm firmash, xhiros e secilit pjesëmarrës;

c) një deklaratë që tregon xhiros e përgjithshme të sektorëve specifikë të cilëve u referohet gara apo një sektori në të cilin, në rast bashkimi të përkohshëm, një shoqëri mendon të kontribuojë;

d) një deklaratë e përshtatshme e përfaqësuesve ligjorë apo një certifikatë bankare, që përmban informacione mbi marrëdhëniet me institucionet bankare me rëndësi ndërkombëtare, me qëllim që të provohet besueshmëria tregtare dhe financiare e konkurrentëve dhe e shoqërive që përbëjnë bashkimin e përkohshëm;

e) një kopje të vërtetimit që provon se konkurruesi është anëtar i Dhomës së Tregtisë në vendin ku është vendosur;

f) në rast bashkimi të përkohshëm, duhet të jepet një kopje e kontratës së bashkimit që tregon se cila shoqëri do të marrë rolin e shoqërisë kryesuese përgjegjëse e solidare kundrejt METE/OST për zbatimin e mundshëm të kontratës;

Kontrolli i aftësive teknike dhe profesionale të konkurruesve përmes:

- një kopje të dokumenteve origjinale që vërtetojnë përbërjen e themelimin ligjor dhe/ ose statusin juridik që përcaktojnë vendin e regjistrimit dhe/ose selinë kryesore ose zyrën e regjistrimit dhe, nëse ato nuk përputhen, vendndodhjen e selisë kryesore të kompanisë, shoqërisë apo partnershipit të zakonshëm, apo të palëve të ndryshme që përbëjnë konkurruesit në rast asociimi të përkohshëm;

- një raport që përmban informacione të dokumentuara mbi përvojat e punës së konkurruesit apo të përshkrimit të përkohshëm në garat që kanë pasur natyrë të ngjashme në tre vjetët paraardhës, dhe që ka të bëjë me gara të tjera që janë duke u zhvilluar me informacione specifike lidhur me pjesëmarrjen efektive e konkrete në çdo garë;

- kualifikimet dhe përvoja e anëtarëve më të rëndësishëm të stafit që do të jetë i ngarkuar nga kontraktuesi për zbatimin e kontratës;

- një raport i shkurtër mbi veprimtarinë e konkurruesve, më vete apo të bashkuar, duke iu referuar në mënyrë specifike veprimtarive që lidhen me programin.

Krahasimi mes konkurruesve do të bëhet në bazë të kritereve të shpalljes së fituesve, sikurse është përcaktuar në njoftimin për zhvillimin e garës dhe në dokumentet e garës. Këto kritere duhet të jenë të tilla që të mos përkrahin diskriminime e as të mos paragjykojnë një konkurrencë të rregullt. Në këto rrethana vlerësimi i çmimit do të përbëjë elementin kryesor për përcaktimin e konkurrentit, i cili nga pikëpamja ekonomike do të jetë më i leverdisshëm.

SHTOJCA 3

PROCEDURAT E ZBATIMIT DHE ADMINISTRIMIT TË KREDISË NDIHMË

SEKSIONI I

NISJA E VEPRIMTARIVE DHE MIRATIMI I PLANIT TË PROKURIMIT

1. PIU/OST e asistuar nga misionet e MPJI/DPBZH do të përgatisë propozimin e planit të prokurimit, që do të përcillet nga OST tek MPJI/DPBZH nëpërmjet ambasadës/NJTV;

2. Plani i prokurimit duhet të organizohet në bazë të garave (sipas rasti të ndarë në grupe), duke treguar për çdo garë shumë që mendohet se do të jetë për përqindjen e shpenzimeve në vend dhe mundësinë për të kryer shpenzime në vend apo në vende të treta;

3. Përqindja totale e shpenzimeve në vend që duhet të zbatohet në vendet e treta nuk duhet të jetë më e madhe se 80% e çdo kontrate;

4. Në garën për realizimin e QDT-së duhet të lejohet një përqindje e përshtatshme për blerje në vende të treta;

5. Shuma totale e shpenzimeve në vend apo për blerje në vende të treta nuk mund të jetë më e madhe se 35% e gjithë shumës së kredisë së ndihmës;

6. Do të zhvillohen vetëm gara të hapura ku mund të marrin pjesë vetëm shoqëri italiane. Nëse OST-ja kërkon t'u drejtohet procedurave të thjeshtuara, duhet të paraqesë pranë MPJI/DPBZH një kërkesë të argumentuar e të qartë për ndryshim;

7. MPJI/DPBZH do të shqyrtojë pra planin e prokurimit nga pikëpamja teknike e ligjore dhe, në rast përfundimi pozitiv, do ta miratojë, duke njoftuar zyrtarisht OST-në, nëpërmjet ambasadës /NJVL.

SEKSIONI II

SHPALLJA E GARAVE, PROCEDURA ZBATUESE

A. PIU/OST dhe PMU/METE do të përgatisin dokumentacionin e nevojshëm për të shpallur garat përkatëse. Ky dokumentacion duhet të përgatitet duke iu referuar parimeve të treguara në shtojcën 2 dhe në përputhje me manualin e procedurave (miratuar nga Komisioni Europian më 23 dhjetor 2002) dhe ndryshime të mundshme të mëvonshme, me përjashtim të pjesës që ka të bëjë me rregullat mbi kombësinë dhe origjinën, së cilës do t'i përshtatet veçoria e kredisë ndihmë italiane, lidhur me: kontraktim, shërbimesh, furnizimesh dhe punimesh në kuadrin e bashkëpunimit komunitar me vendet e treta.

- Dokumentacioni sidoqoftë:

- duhet të specifikojë “kushtet e veçanta” në lidhje me çdo garë;

- duhet të tregojë qartë kriteret vlerësuese që do të përdoren nga komisioni i vlerësimit.

B. Mënyra e veprimit:

B1-Përgatitja e dokumentacionit të garës.

-PIU/OST dhe PMU/METE do të përgatisë dokumentacionin e garës, duke u mbështetur në punën e konsulentit.

B2-Kontrolli i përputhshmërisë së dokumentacionit të garës.

Dokumentacioni i garës, për secilin prej zërave të parashikuar në planin e prokurimit të miratuar nga Palët, do të përcillet te MPJI/DPBZH nëpërmjet ambasadës/NJTV së bashku me kërkesën për shpalljen për zhvillimin e garës. MPJI/DPBZH pasi kryen verifikimet që i takojnë asaj në lidhje me përputhshmërinë e këtij dokumentacioni me dispozitat e parashikuara në këtë Marrëveshje do të japë, siç janë parashikuar, miratimin për shpalljen e njoftimit për zhvillimin e garës.

Në këtë plan prokurimi do të tregohen, për secilën garë, strukturat shqiptare të ngarkuara për administrimin përkatës (PIU/OST ose PMU/MECE) në mënyrë që të sigurohet tërësia e administrimit dhe realizimit të disa impianteve që bëjnë pjesë në disa objekte të tjera, të cilat po realizohen në kuadër të linjës së kredisë së mëparshme për sektorin elektrik të financuar nga kooperacioni italian.

Ky verifikim, në mënyrë të veçantë, do të mbështetet në përputhjen:

- e garës me planin e prokurimit të miratuar;
- e përmbajtjes me karakter ligjor me procedurat e treguara në shtojcën 2;
- e specifikave teknike dhe parametrave të vlerësimit me objektivat që Programi synon të arrijë.

B3 -Shpallja e zhvillimit të garës

Në rast se kontrolli do të kish një rezultat pozitiv, njoftimi për zhvillimin e garës do të botohet njëkohësisht në Itali e në Shqipëri. Botimi në Itali do të kryhet nën kujdesin e MPJI/DPBZH, në gazetën e përditshme italiane, në buletin e kooperacionit dhe në faqen e internetit të MPJI. PMU/METE dhe PIU/OST do të procedojë njëkohësisht me botimin e njoftimit për zhvillimin e garës në gazetën kombëtare.

SEKSIONI III

FAZA E SHPALLJES SË FITUESIT-PROCEDURA ZBATUESE

A-Zhvillimi i procedurave të garës dhe verifikimi i përshtatshmërisë së kritereve të përdorura nga komisioni i vlerësimit:

- Çdonjëra prej garave të parashikuara në planin e prokurimit do të zhvillohet duke u mbështetur tek një komision vlerësues, i cili do të caktohet nga OST-ja;

- PIU/OST dhe PMU/METE do të ndjekin ecurinë e garave përkatëse, duke asistuar teknikisht me komisionin e vlerësimit, i cili do të mbajë procesverbale të posaçme, me qëllim që të sigurohet një zhvillim korrekt dhe i standardizuar i procedurave dhe me qëllim të lehtësimit maksimal të procesit të vlerësimit nga ana e anëtarëve që kanë të drejtë vote, që do të veprojnë nën supervizionin e kryetarit.

- Në kohën e hapjes së ofertave do të marrë pjesë në cilësinë e vëzhguesit një përfaqësues i caktuar nga ambasada/NJTV.

B-Mënyra e veprimit

B1-Për çdo garë, OST-së do të përcjellë pranë ambasadës italiane /NJTV dokumentacionin që përmban procesverbalet, rezultatet e vlerësimit të ofertave, propozimin për caktimin e fituesit dhe kontratën që duhet lidhur, dhe e cila do t'ia përcjellë më pas MPJI-DPBZH.

B2-MPJI-DPBZH do të verifikojë kryesisht përputhjen ligjore dhe teknike të vlerësimeve të kryera me procedura dhe kriteret/parametrat e parashikuar në pjesën e posaçme të dokumenteve të garës dhe në këtë Marrëveshje.

B3-Në përfundim të verifikimeve, MPJI-DPBZH do të njoftojë OST, nëpërmjet ambasadës/NJTV, në lidhje me përfundimin e tyre (miratim).

B4-Nëse është e nevojshme, ambasada/ZTL mund të kërkojë të kontrollojë dokumentacionin e garës, përfshirë këtu ofertat.

B5-Në rast se vlerësimet do të jenë pozitive, OST do të procedojë për nënshkrimin e kontratës me shoqërinë që do të shpallet fituese.

SEKSIONI IV
FAZA E BËRJES EFEKTIVE TË KONTRATAVE DHE PROCEDURAVE ZBATUESE

1. Kontratat e lidhura zyrtarisht mes shoqërive fituese dhe OST duhet të dërgohen pranë MPJI/DPBZH përmes ambasadës /NJTV, me një deklaratë angazhimi të palës shqiptare për të përballuar kostot lokale në lidhje me tatimin mbi vlerën e shtuar, taksat doganore, shpenzimet etj.

2. Pasi të ketë verifikuar përshtatshmërinë e kontratës me dokumentet e tenderit, MPJI/DPBZH do të dërgojë pranë AFQ (Artigiancassa) miratimin për lidhjen e kontratës në linjën e kredisë.

3. Sapo të marrë miratimin e mësipërm siç është parashikuar në pikën 2, Artigiancassa do të plotësojë praktikën përgatitore, në mënyrë të veçantë në lidhje me eksportuesin italian. Më pas, kur kjo praktikë përgatitore të ketë përfunduar me sukses dhe pasi të ketë marrë kërkesën për financim nga ana e kredimarrësit, Artigiancassa do t'i njoftojë këtij të fundit, eksportuesit dhe MPJI/DPBZH për përfshirjen e kontratës në linjën e kredisë.

4. Artigiancassa do të njoftojë drejtpërdrejt furnitorët, pasi të ketë marrë prej tyre kërkesën për pagesën e kontratës, së bashku me dokumentacionin administrativ të bashkëngjitur parashikuar për kontratat e veçanta (fatura tregtare, packing list, bill of lading etj.) dhe pasi të ketë verifikuar përputhshmërinë e këtij dokumentacioni me kontratën e autorizuar. (Një kopje e kërkesës për pagim do të dërgohet pranë kredimarrësit).Pagesat mund të kryhen vetëm pasi të merret autorizimi për të proceduar nga ana e kredimarrësit; ky autorizim duhet sidoqoftë të merret brenda 30 ditësh duke filluar nga data e kërkesës për pagim të paraqitur. MPJI/DPBZH.

LIGJ
Nr. 9613, datë 21.9.2006

PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË KONVENTËN E UNESCO-S “PËR MBROJTJEN DHE ZHVILLIMIN E LARMISË SË SHPREHJEVE TË KULTURAVE”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në Konventën e UNESCO-s “Për mbrojtjen dhe zhvillimin e larmisë së shprehjeve të kulturave”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5062, datë 4.10.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

KONVENTA
PËR MBROJTJEN DHE ZHVILLIMIN E LARMISË SË SHPREHJEVE KULTURORE

Paris, 20 tetor 2005

Konferenca e Përgjithshme e Organizatës Edukative, Shkencore dhe Kulturore të Kombeve të Bashkuara, mbledhur në Paris nga data 3 deri në 21 tetor 2005 në sesionin e saj të 33-të:

duke pohuar që larmia kulturore është një karakteristikë përcaktuese e njerëzimit;

e ndërgjegjshme që larmia kulturore krijon një trashëgimi të përbashkët të njerëzimit dhe që duhet të zhvillohet dhe ruhet për të mirën e të gjithëve;

me vetëdije që larmia kulturore krijon një botë të pasur dhe të larmishme, e cila rrit gamën e zgjedhjeve dhe ushqen kapacitetet dhe vlerat e njeriut dhe për rrjedhojë është një forcë shtytëse për zhvillimin e qëndrueshëm për komunitetet, popujt dhe kombet;

duke kujtuar që larmia kulturore, e cila zhvillohet brenda kuadrit të demokracisë, tolerancës, drejtësisë sociale dhe respektit reciprok ndërmjet njerëzve dhe kulturave është e domosdoshme për paqen dhe sigurinë në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar;

duke përkujtuar rëndësinë e larmisë kulturore për realizimin e plotë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut të shpallura në Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut dhe në instrumente të tjera të njohura në gjithë botën;

duke theksuar nevojën për të përfshirë kulturën si një element strategjik në politikat e zhvillimit kombëtar dhe ndërkombëtar, si dhe në bashkëpunimin për zhvillimin ndërkombëtar, duke pasur parasysh gjithashtu Deklaratën e Mijëvjeçarit (2000) të Kombeve të Bashkuara që i vë theks të veçantë zhdukjes së varfërisë;

duke pasur parasysh që kultura merr trajta të ndryshme në kohë dhe hapësirë dhe që kjo larmi është mishëruar në veçantinë dhe shumësinë e identiteteve dhe shprehjeve kulturore të popujve dhe shoqërive që krijojnë njerëzimin;

duke pranuar rëndësinë e njohurive tradicionale si një burim i pasurisë së paprekshme dhe materiale dhe në veçanti sistemet e njohurive të popujve indigjenë dhe kontributin e tyre pozitiv në zhvillimin e qëndrueshëm, si edhe nevojën për mbrojtjen dhe zhvillimin e duhur të tyre;

duke pranuar nevojën për marrjen e masave për të mbrojtur larminë e shprehjeve kulturore, përfshirë këtu përmbajtjen e tyre, veçanërisht në situata ku shprehjet kulturore mund të kërcënohen nga mundësia e zhdukjes apo e dëmtimit serioz;

duke theksuar rëndësinë e kulturës për kohezion social në përgjithësi dhe veçanërisht potencialin e saj për rritjen e statusit dhe rolit të gruas në shoqëri;

e vetëdijshme që larmia kulturore forcohet me anë të fluksit të lirë të ideve dhe që rritet me anë të shkëmbimit dhe ndërveprimit të vazhdueshëm ndërmjet kulturave;

duke pohuar sërish që liria e mendimit, shprehjes dhe informacionit, si dhe larmia e medias, bëjnë të mundur që shprehjet kulturore të zhvillohen brenda shoqërive;

duke pranuar që larmia e shprehjeve kulturore, përfshirë këtu shprehjet kulturore tradicionale është një faktor i rëndësishëm që lejon individët dhe popujt të shprehin dhe të ndajnë me të tjerët idetë dhe vlerat e tyre;

duke kujtuar që larmia gjuhësore është një element thelbësor i larmisë kulturore dhe duke pohuar sërish rolin thelbësor që luan edukimi në mbrojtjen dhe zhvillimin e shprehjeve kulturore;

duke pasur parasysh rëndësinë e forcës së kulturës, përfshirë këtu personat që u përkasin minoriteteve dhe popujve indigjenë, të manifestuar në lirinë e tyre për të krijuar, përhapur dhe ndarë shprehjet tradicionale kulturore dhe për të pasur mundësinë e përdorimit të tyre, me qëllim që t'i përfitojnë ato për zhvillimin e tyre;

duke theksuar rolin e rëndësishëm të ndërveprimit dhe krijueshmërisë kulturore që rrisin dhe ripërtërijnë shprehjet kulturore dhe rrisin rolin që luajnë të interesuarit e përfshirë në zhvillimin e kulturës për ecurinë e gjithë shoqërisë;

duke pranuar rëndësinë e të drejtave të pronësisë intelektuale në mbështetje të të interesuarve të përfshirë në krijueshmërinë kulturore;

e bindur që veprimtaritë, të mirat dhe shërbimet kulturore janë të një natyre ekonomike dhe kulturore, sepse përcjellin identitete, vlera dhe kuptime dhe për këtë nuk duhet të trajtohen vetëm për vlerën tregtare;

duke vënë në dukje që ndërsa proceset e globalizimit të cilat janë lehtësuar nga zhvillimi i shpejtë i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, përballojnë kushtet pa precedent për ndërveprim të rritur ndërmjet kulturave, ato paraqesin gjithashtu një sfidë për larminë kulturore, kryesisht duke pasur parasysh rreziqet e çekuilibrit ndërmjet vendeve të varfra dhe të pasura;

e vetëdijshme për mandatin e veçantë të UNESCO-s për të siguruar respektimin e larmisë së kulturave dhe për të rekomanduar këto marrëveshje ndërkombëtare që mund të jenë të nevojshme për nxitjen e fluksit të lirë të ideve me anë të fjalës dhe imazhit;

duke i'u referuar dispozitave të instrumenteve ndërkombëtare të miratuara nga UNESCO në lidhje me larminë kulturore dhe ushtrimin e të drejtave kulturore dhe në veçanti Deklaratës Universale për Larminë Kulturore të vitit 2001;

miraton këtë Konventë më 20 tetor 2005

I. OBJEKTIVAT DHE PARIMET DREJTUESE

Neni 1

Objektivat

Objektivat e kësaj Konvente janë:

- a) të mbrojnë dhe të zhvillojnë larminë e shprehjeve kulturore;
- b) të krijojnë kushtet që kulturat të zhvillohen dhe të ndërveprojnë lirshëm në një mënyrë huazi të dobishme;
- c) të inkurajojnë dialogun ndërmjet kulturave me synim që të sigurojë një shkëmbim më të madh dhe të balancuar kulturor në botë në favor të respektit ndërkulturor dhe një kulture të paqes;
- d) të nxisë ndërthurjen kulturore për të zhvilluar ndërveprimin kulturor me frymën e ndërtimit të urave ndërmjet popujve;
- e) të nxisë respektin për larminë e shprehjeve kulturore dhe të ndërgjegjësojë vlerat e saj në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar;
- f) të pohojë sërish rëndësinë e lidhjes ndërmjet kulturës dhe zhvillimit për të gjitha vendet, veçanërisht për vendet në zhvillim dhe të përkrahë masat e ndërmarra në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar për të siguruar njohjen e vlerës së vërtetë të kësaj lidhjeje;
- g) të bëjë të kuptueshme natyrën e veçantë të veprimtarive, të mirave dhe shërbimeve kulturore, si mjete të identitetit, vlerave dhe kuptimit;
- h) të pohojë sërish të drejtat sovrane të shteteve për të ruajtur, miratuar dhe zbatuar politikatat dhe masat që ato i gjykojnë të duhura për mbrojtjen dhe zhvillimin e larmisë së shprehjeve kulturore në territorin e tyre;
- i) të forcojë bashkëpunimin dhe solidaritetin ndërkombëtar me frymën e partneritetit me synim, në veçanti, rritjen e kapaciteteve të vendeve në zhvillim për të mbrojtur dhe zhvilluar larminë e shprehjeve kulturore.

Neni 2

Parimet drejtuese

1. Parimi i respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut

Larmia kulturore mund të mbrohet dhe të zhvillohet vetëm nëse garantohen të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si liria e shprehjes, informacionit dhe komunikimit, si dhe aftësia e individëve për të zgjedhur shprehjet kulturore. Askush nuk mund të përdorë dispozitat e kësaj Konvente për të shkelur të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të shpallura në Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut, të garantuara në të drejtën ndërkombëtare ose të kufizojë fushën e veprimit.

2. Parimi i sovranitetit

Shtetet në përputhje me Kartën e Kombeve të Bashkuara dhe parimet e së drejtës ndërkombëtare, kanë të drejtën sovrane të miratojnë masa dhe politika për të mbrojtur dhe zhvilluar larminë e shprehjeve kulturore brenda territorit të tyre.

3. Parimi i dinjitetit të barabartë dhe i respektimit të të gjitha kulturave

Mbrojtja dhe zhvillimi i larmisë së shprehjeve kulturore prezumon njohjen e dinjitetit të barabartë dhe respektimin e të gjitha kulturave, përfshirë këtu kulturat e personave që u përkasin minoriteteve dhe popujve indigjenë.

4. Parimi i solidaritetit dhe bashkëpunimit ndërkombëtar

Bashkëpunimi dhe solidariteti ndërkombëtar duhet të synojnë që të bëjnë të mundur që vendet, veçanërisht vendet në zhvillim, të krijojnë dhe të forcojnë mënyrat e tyre të shprehjes kulturore, përfshirë këtu industritë e tyre kulturore, në lindje e sipër apo të krijuara, në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar.

5. Parimi i komplementaritetit të aspekteve ekonomike dhe kulturore të zhvillimit

Meqë kultura është një nga forcat lëvizëse të zhvillimit, aspektet kulturore të zhvillimit janë po aq të rëndësishme sa aspektet ekonomike në të cilat individët dhe popujt kanë të drejtën themelore të marrin pjesë dhe t'i gëzojnë ato.

6. Parimi i zhvillimit të qëndrueshëm

Larmia kulturore është një aset i pasur për individët dhe shoqëritë. Mbrojtja, zhvillimi dhe ruajtja e larmisë kulturore janë një kërkesë thelbësore për zhvillimin e qëndrueshëm në të mirë të brezave të së tashmes dhe të së ardhmes.

7. Parimi i përdorimit të arsyeshëm

E drejta e përdorimit të arsyeshëm të një game të pasur dhe të larmishme të shprehjeve kulturore nga e gjithë bota dhe e drejta e kulturave për të përdorur mjetet e shprehjes dhe shpërndarjes përbëjnë elementë të rëndësishëm për rritjen e larmisë kulturore dhe inkurajimin e kuptimit reciprok.

8. Parimi i hapjes dhe i ekuilibrit

Kur Shtetet miratojnë masa për të përkrahur larminë e shprehjeve kulturore, ato duhet të zhvillojnë, në mënyrën e duhur, hapjen ndaj kulturave të tjera të botës dhe të sigurojnë që këto masa të hartohen për objektivat e ndjekura sipas Konventës në fjalë.

II. FUSHA E ZBATIMIT

Neni 3

Fusha e zbatimit

Kjo Konventë zbatohet për politikat dhe masat e miratuara nga Palët në lidhje me mbrojtjen dhe zhvillimin e larmive të shprehjeve kulturore.

III. PËRKUFIZIME

Neni 4

Përkufizime

Për qëllimet e kësaj Konvente, kuptohet që:

1. Larmi kulturore

“Larmia kulturore” ka të bëjë me mënyrat e ndryshme ku gjejnë shprehje kulturat dhe shoqëritë. Këto shprehje kalojnë midis dhe ndërmjet grupeve dhe shoqërive.

Larmia kulturore është shfaqur jo vetëm përmes mënyrave të ndryshme me anë të të cilave shprehet trashëgimia kulturore e njerëzimit, e rritur dhe e transmetuar përmes larmisë së shprehjeve kulturore, por edhe përmes mënyrave të ndryshme të krijimit artistik, prodhimit, shpërndarjes, ndarjes dhe gëzimit të tyre, çfarëdo qofshin mjetet dhe teknologjitë e përdorura.

2. Përbajtje kulturore

“Përbajtja kulturore” ka të bëjë me kuptimin simbolik, dimensionin artistik dhe vlerat kulturore që e kanë origjinën nga, ose që shprehin identitete kulturore.

3. Shprehje kulturore

“Shprehje kulturore” janë shprehjet që rezultojnë nga krijueshmëria e individëve, grupeve dhe shoqërive dhe që kanë përbajtje kulturore.

4. Veprimtari, të mira dhe shërbime kulturore

“Veprimtaritë, të mirat dhe shërbimet kulturore” janë veprimtaritë, të mirat dhe shërbimet që në kohën kur janë konsideruar si një atribut, përdorim apo qëllim specifik, mishërojnë ose përcjellin shprehje kulturore, pavarësisht nga vlera tregtare që mund të kenë.

Veprimtaritë kulturore mund të jenë qëllim në vetvete ose mund të kontribuojnë në prodhimin e të mirave dhe shërbimeve kulturore.

5. Industritë kulturore

“Industritë kulturore” janë industritë që prodhojnë dhe shpërndajnë mallra ose shërbime kulturore të përkufizuara në paragrafin 4.

6. Politikat dhe masat kulturore

“Politikat dhe masat kulturore” janë ato politika dhe masa që lidhen me kulturën, në nivel lokal, kombëtar, rajonal ose ndërkombëtar të cilat ose janë përqendruar në kulturën si të tillë, ose janë hartuar për të pasur një ndikim të drejtpërdrejtë në shprehjet kulturore të individëve, grupeve ose shoqërive, duke përfshirë krijimin, prodhimin, ndarjen, shpërndarjen dhe të drejtën e veprimtarive, të mirave dhe shërbimeve kulturore.

7. Mbrojtja

“Mbrojtja” ka të bëjë me miratimin e masave që synojnë ruajtjen, sigurimin dhe shtimin e larmisë së shprehjeve kulturore.

“Mbroj” do të thotë miratoj këto masa.

8. Ndërthurja kulturore

“Ndërthurja kulturore” ka të bëjë me ekzistencën dhe ndërveprimin e drejtë të kulturave të ndryshme dhe mundësinë e prodhimit të shprehjeve të përbashkëta kulturore me anë të dialogut dhe respektit të ndërsjellë.

IV. TË DREJTAT DHE DETYRIMET E PALËVE

Neni 5

Rregulli i përgjithshëm në lidhje me të drejtat dhe detyrimet

1. Palët, në përputhje me Kartën e Kombeve të Bashkuara, parimet e së drejtës ndërkombëtare dhe instrumente për të drejtat e njeriut të njohura në botë, pohojnë sërish të drejtën e tyre sovranë për të formuluar dhe zbatuar politikat e tyre kulturore dhe për të miratuar masat për të mbrojtur dhe zhvilluar larminë e shprehjeve kulturore, si dhe për të forcuar bashkëpunimin ndërkombëtar për arritjen e qëllimeve të kësaj Konvente.

2. Kur një Palë zbaton politika dhe merr masa për të mbrojtur dhe zhvilluar larminë e shprehjeve kulturore brenda territorit të saj, politikat dhe masat e saj do të jenë në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente.

Neni 6

Të drejtat e palëve në nivel kombëtar

1. Secila Palë, brenda kuadrit të politikave dhe masave të saj kulturore si përkufizohen në nenin 4.6 dhe duke pasur parasysh rrethanat dhe nevojat e saj të veçanta, mund të miratojë masat që synojnë mbrojtjen dhe zhvillimin e larmisë së shprehjeve kulturore brenda territorit të saj.

2. Këto masa mund të përfshijnë sa më poshtë:

a) masat rregullatore që synojnë mbrojtjen dhe zhvillimin e larmisë së shprehjeve kulturore;

b) masat që, në mënyrën e duhur, sigurojnë mundësi për veprimtari, të mira dhe shërbime kulturore në vend midis të gjitha atyre që janë në dispozicion brenda territorit kombëtar për krijimin, prodhimin, ndarjen, shpërndarjen dhe gëzimin e këtyre veprimtarive, të mirave dhe shërbimeve kulturore në vend;

c) masat që synojnë të sigurojnë për industrinë kulturore të pavarura në vend dhe veprimtarinë në sektorin jo formal të drejtën e përdorimit efektiv të mjeteve të prodhimit, shpërndarjes dhe ndarjes së veprimtarive, të mirave dhe shërbimeve kulturore;

d) masa që synojnë të sigurojnë ndihmës publike financiare;

e) masat që synojnë të inkurajojnë organizatat jo fitimprurëse, si dhe institucionet publike dhe private dhe artistët dhe profesionistët e tjerë kulturorë, të zhvillojnë dhe të nxisin shkëmbimin dhe qarkullimin e lirë të ideve, shprehjeve kulturore dhe veprimtarive, të mirave dhe shërbimeve kulturore dhe të nxisin frymën krijuese dhe sipërmarrëse në veprimtaritë e tyre;

f) masat që synojnë të krijojnë dhe përkrahin institucionet publike, në formën e duhur;

g) masat që synojnë të nxisin dhe të përkrahin artistët dhe të tjerë të përfshirë në krijimin e shprehjeve kulturore;

h) masat që synojnë të rrisin larminë e medias, duke përfshirë transmetimin e shërbimit publik.

Neni 7

Masat për të zhvilluar shprehjet kulturore

1. Palët do të përpiqen të krijojnë në territorin e tyre një mjedis që inkurajon individët dhe grupet shoqërore:

a) të krijojnë, prodhojnë, ndajnë, shpërndajnë dhe përdorin shprehjet e tyre kulturore, duke i kushtuar vëmendjen e duhur rrethanave dhe nevojave të veçanta të grave, si dhe grupeve të ndryshme shoqërore, përfshirë personat që u përkasin minoriteteve dhe popujve indigjenë;

b) të përdorin shprehje të ndryshme kulturore nga territori i tyre, si dhe nga vende të tjera të botës.

2. Palët do të përpiqen gjithashtu të njohin kontributin e rëndësishëm të artistëve, të të tjerëve të përfshirë në procesin krijues, komuniteteve kulturore dhe organizatave që mbështesin punën e tyre dhe rolin e tyre thelbësor në rritjen e larmisë së shprehjeve kulturore.

Neni 8

Masat për të mbrojtur shprehjet kulturore

1. Pa paragjykuar dispozitat e neneve 5 dhe 6, një Palë mund të përcaktojë ekzistencën e situatave të veçanta ku shprehjet kulturore në territorin e saj janë në rrezik për zhdukje, në kërcënim të rëndë ose në të kundërt në nevojë për mbrojtje urgjente.

2. Palët mund të marrin të gjitha masat e duhura për të mbrojtur dhe ruajtur shprehjet kulturore në situatat e përmendura në paragrafin 1 në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente.

3. Palët i raportojnë Komitetit Ndërqeveritar të përmendur në nenin 23 për të gjitha masat e marra për të përballuar nevojën urgjente të situatës dhe Komiteti mund të bëjë rekomandimet e duhura.

Neni 9

Ndarja e informacionit dhe transparenca

Palët:

a) sigurojnë informacionin e duhur në raportet e tyre për UNESCO-n çdo katër vjet mbi masat e marra për të mbrojtur dhe zhvilluar larminë e shprehjeve kulturore brenda territorit të tyre dhe në nivel ndërkombëtar;

b) caktojnë një pikë kontakti përgjegjës për ndarjen e informacionit në lidhje me këtë Konventë;

c) ndajnë dhe shkëmbejnë informacion në lidhje me mbrojtjen dhe zhvillimin e larmisë së shprehjeve kulturore.

Neni 10

Edukimi dhe ndërgjegjësimi i publikut

Palët:

a) inkurajojnë dhe nxisin kuptimin e rëndësisë së mbrojtjes dhe zhvillimit të larmisë së shprehjeve kulturore, inter alia, me anë të programeve edukative dhe programeve që ndërgjegjësojnë publikun më tepër;

b) bashkëpunojnë me palët e tjera dhe organizatat ndërkombëtare dhe rajonale për të arritur qëllimin e këtij neni;

c) përpiqen të inkurajojnë krijueshmërinë dhe të forcojnë kapacitetet e prodhimit duke krijuar programe edukative, trajnime dhe shkëmbimi në fushën e industrive kulturore. Këto masa duhet të zbatohen në një mënyrë që nuk ndikon negativisht në format tradicionale të prodhimit.

Neni 11

Pjesëmarrja e shoqërisë civile

Palët e njohin rolin themelor të shoqërisë civile në mbrojtjen dhe zhvillimin e larmisë së shprehjeve kulturore. Palët inkurajojnë pjesëmarrjen aktive të shoqërisë civile në përpjekjet e tyre për të arritur objektivat e kësaj Konvente.

Neni 12

Nxitja e bashkëpunimit ndërkombëtar

Palët përpiqen të forcojnë bashkëpunimin e tyre dypalësh, rajonal dhe ndërkombëtar për krijimin e kushteve që nxisin zhvillimin e larmisë së shprehjeve kulturore, duke marrë parasysh në veçanti situatat e përmendura në nenet 8 dhe 17, sidomos me qëllim që:

a) të lehtësohet dialogu për politikën kulturore ndërmjet Palëve;

b) të rriten kapacitetet e menaxhimit dhe ato strategjike të sektorit publik në institucionet kulturore të sektorit publik me anë të shkëmbimeve kulturore profesionale dhe ndërkombëtare dhe ndarjes së praktikave më të mira;

c) të forcohen partneritetet me dhe ndërmjet shoqërisë civile, organizatave joqeveritare dhe sektorit privat për nxitjen dhe zhvillimin e larmisë së shprehjeve kulturore;

d) të nxitet përdorimi i teknologjive të reja, të inkurajohen partneritetet për të shtuar ndarjen e informacionit dhe mirëkuptimin kulturor dhe të nxitet larmia e shprehjeve kulturore;

e) të inkurajohet përfundimi i marrëveshjeve për bashkëprodhim dhe bashkëshpërndarje.

Neni 13

Integrimi i kulturës në zhvillimin e qëndrueshëm

Palët përpiqen të përfshijnë kulturën në politikat e tyre të zhvillimit në të gjitha nivelet për krijimin e kushteve që nxisin zhvillimin e qëndrueshëm dhe, brenda këtij kuadri, të nxisin aspektet në lidhje me mbrojtjen dhe zhvillimin e larmisë së shprehjeve kulturore.

Neni 14

Bashkëpunimi për zhvillim

Palët përpiqen të përkrahin bashkëpunimin për zhvillimin e qëndrueshëm dhe reduktimin e varfërisë, veçanërisht në lidhje me nevojat specifike të vendeve në zhvillim, me synim nxitjen e shfaqjes së një sektori dinamik kulturor, inter alia, me anë të mënyrave të mëposhtme:

- a) duke forcuar industrinë kulturore në vendet në zhvillim me anë të:
- i) krijimit dhe forcimit të prodhimit kulturor dhe kapaciteteve të shpërndarjes në vendet në zhvillim;
 - ii) lehtësimit të përdorimit më të gjerë në tregun botëror dhe në rrjetet ndërkombëtare të shpërndarjes për veprimtarinë, të mirat dhe shërbimet e tyre kulturore;
 - iii) mundësisimit të shfaqjes së tregjeve të suksesshme lokale dhe rajonale;
 - iv) miratimit, kur është e mundur, të masave të duhura në vendet e zhvilluara me synim lehtësimin e përdorimit në territorin e tyre të veprimtarive, të mirave dhe shërbimeve kulturore të vendeve në zhvillim;
 - v) sigurimit të përkrahjes për punë krijuese dhe lehtësimit të lëvizjes, sa më shumë të jetë e mundur, e artistëve nga bota në zhvillim;
 - vi) inkurajimit të duhur të bashëpunimit ndërmjet vendeve të zhvilluara dhe në zhvillim në fushat, inter alia, e muzikës dhe filmit;
- b) duke forcuar kapacitetet me anë të shkëmbimit të informacionit, përvojës dhe ekspertizës, si dhe duke trajnuar burimet njerëzore në vendet në zhvillim, në sektorin privat dhe publik në lidhje me inter alia, kapacitetet strategjike dhe të menaxhimit, zhvillimin dhe zbatimin e politikave, zhvillimin dhe shpërndarjen e shprehjeve kulturore, zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, përdorimin e teknologjisë dhe zhvillimin dhe transferimin e aftësive;
- c) duke transferuar teknologjinë me anë të prezantimit të masave të duhura nxitëse për transferimin e teknologjisë dhe njohurive, veçanërisht në fushën e industrive dhe ndërmarrjeve kulturore;
- d) duke siguruar ndihmë financiare me anë të:
- i) krijimit të një fondi ndërkombëtar për larminë kulturore si parashikohet në nenin 18;
 - ii) sigurimit të ndihmës për zhvillimin, sipas rastit, përfshirë këtu ndihmën teknike, për të nxitur dhe përkrahur krijueshmërinë;
 - iii) formave të tjera të ndihmës financiare si interesa të ulta huaje, grante dhe mekanizma të tjerë financimi.

Neni 15

Rregullime bashkëpunuese

Palët inkurajojnë zhvillimin e partneriteteve ndërmjet dhe brenda sektorëve publikë dhe privatë dhe organizatave jo fitimprurëse për të bashkëpunuar me vendet në zhvillim në lidhje me rritjen e kapaciteteve të tyre për të mbrojtur dhe zhvilluar larminë e shprehjeve kulturore. Këto partneritete të reja sipas nevojave praktike të vendeve në zhvillim theksojnë zhvillimin e mëtejshëm të infrastrukturës, burimeve njerëzore dhe politikave, si dhe shkëmbimin e veprimtarive, të mirave dhe shërbimeve kulturore.

Neni 16

Trajtimi preferencial për vendet në zhvillim

Vendet e zhvilluara lehtësojnë shkëmbimet kulturore me vendet në zhvillim duke u dhënë artistëve, profesionistëve dhe ekspertëve të tjerë kulturorë, me anë të strukturave të duhura institucionale dhe ligjore, trajtim preferencial, si dhe të mira dhe shërbime kulturore nga vendet në zhvillim.

Neni 17

Bashkëpunimi ndërkombëtar në situata që janë kërcënim i rëndë për shprehjet kulturore

Palët bashkëpunojnë për të siguruar ndihmë për njëra-tjetrën dhe në veçanti për vendet në zhvillim, në situatat e përmendura në nenin 8.

Neni 18

Fondi Ndërkombëtar për Larminë Kulturore

1. Një Fond Ndërkombëtar për Larminë Kulturore, tani e tutje i përmendur si “Fondi” krijohet në këtë mënyrë.
2. Fondi përbëhet nga fonde në mirëbesim të krijuara në përputhje me rregulloret financiare të UNESCO-s.
3. Burimet e Fondit përbëhen nga:
 - a) kontribute vullnetare të bëra nga palët;
 - b) fonde të caktuara për këtë qëllim nga Konferenca e Përgjithshme e UNESCO-s;
 - c) kontribute, dhurata apo trashëgimi nga Shtete të tjera; organizata dhe programe të sistemit të Kombeve të Bashkuara, organizata të tjera rajonale ose ndërkombëtare; organe apo individë publikë ose privatë;
 - d) çdo interes për burimet e Fondit;
 - e) fondet e mbledhura me anë të mbledhjeve dhe arkëtimeve nga ngjarjet e organizuara për përfitim të Fondit;
 - f) burime të tjera të autorizuara nga rregulloret e fondit.
4. Përdorimi i burimeve të Fondit vendoset nga Komiteti Ndërqeveritar në bazë të udhëzimeve të caktuara nga Konferenca e Palëve e përmendur në nenin 22.
5. Komiteti Ndërqeveritar mund të pranojë kontribute dhe forma të tjera të ndihmës për qëllime të përgjithshme dhe specifike në lidhje me projekte specifike, me kusht që këto projekte të jenë të miratuara prej tij.
6. Asnjë kusht politik, ekonomik apo tjetër që nuk është në pajtim me objektivat e kësaj Konvente nuk mund t’i bashkëngjitet kontributeve që janë bërë për Fondin.
7. Palët përpiqen të sigurojnë rregullisht kontribute vullnetare për zbatimin e kësaj Konvente.

Neni 19

Shkëmbimi, analizimi dhe përhapja e informacionit

1. Palët bien dakord të shkëmbejnë informacion dhe të ndajnë ekspertizën në lidhje me mbledhjen e të dhënave dhe statistikave për larminë e shprehjeve kulturore, si dhe për praktikën më të mira për mbrojtjen dhe zhvillimin e saj.
2. UNESCO lehtëson, me anë të përdorimit të mekanizmave ekzistues brenda Sekretariatit, mbledhjen, analizimin dhe përhapjen e të gjithë informacionit përkatës, statistikave dhe praktikave më të mira.
3. UNESCO krijon gjithashtu dhe përditëson një bankë të dhënash për sektorë të ndryshëm dhe organizata qeveritare, private dhe jofitimprurëse të përfshirë në fushën e shprehjeve kulturore.
4. UNESCO, për të lehtësuar mbledhjen e të dhënave, i kushton vëmendje të veçantë rritjes së kapaciteteve dhe forcimit të ekspertizës për Palët që paraqesin një kërkesë për këtë ndihmë.
5. Mbledhja e informacionit të identifikuar në këtë nen plotëson informacionin e mbledhur sipas dispozitave të nenit 9.

V. MARRËDHËNIA ME INSTRUMENTE TË TJERA

Neni 20

Marrëdhënia me traktate të tjera: mbështetja reciproke, komplementariteti dhe mosvartësia

1. Palët pranojnë që do të përmbushin me mirëbesim detyrimet e tyre sipas kësaj Konvente dhe të gjitha traktateve të tjera ku ato janë palë. Prandaj, pa e vënë këtë Konventë në varësi të traktateve të tjera,
 - a) ato do të nxisin mbështetjen reciproke ndërmjet kësaj Konvente dhe traktatet e tjera ku ato janë palë; dhe

b) palët, gjatë interpretimit dhe zbatimit të traktateve të tjera ku janë palë ose gjatë përfshirjes në detyrime të tjera ndërkombëtare, do të marrin parasysh dispozitat përkatëse të kësaj Konvente.

2. Asgjë në këtë Konventë nuk interpretohet si ndryshuese e të drejtave dhe detyrimeve të Palëve sipas ndonjë traktati tjetër ku ato janë palë.

Neni 21

Konsultimi dhe bashkërendimi ndërkombëtar

Palët marrin përsipër të zhvillojnë objektivat dhe parimet e kësaj Konvente në forume të tjera ndërkombëtare. Për këtë qëllim, Palët konsultojnë me njëra-tjetrën, sipas rastit, duke pasur parasysh këto objektiva dhe parime.

VI. ORGANET E KONVENTËS

Neni 22

Konferenca e Palëve

1. Një Konferencë e Palëve do të krijohet. Konferenca e Palëve është organi plenar dhe suprem i kësaj Konvente.

2. Konferenca e Palëve mbledhet në sesion të zakonshëm çdo dy vjet, sa është e mundur, së bashku me Konferencën e Përgjithshme të UNESCO-s. Ajo mund të mbledhet në sesion të jashtëzakonshëm nëse vendos, ose nëse Komiteti Ndërqeveritar merr një kërkesë për këtë qëllim të paktën nga një e treta e Palëve.

3. Konferenca e Palëve miraton rregulloren e saj të brendshme.

4. Funksionet e Konferencës së Palëve, inter alia, janë

a) të zgjedhë anëtarët e Komitetit Ndërqeveritar;

b) të marrë dhe të shqyrtojë raportet e palëve të kësaj Konvente të transmetuara nga Komiteti Ndërqeveritar;

c) të miratojë udhëzimet funksionale të përgatitura me kërkesë të saj nga Komiteti Ndërqeveritar;

d) të marrë çfarëdo masa të tjera që mund t'i konsiderojë të nevojshme për të përparuar me objektivat e kësaj Konvente.

Neni 23

Komiteti Ndërqeveritar

1. Një Komitet Ndërqeveritar për Mbrojtjen dhe Zhvillimin e Larmisë së Shprehjeve Kulturore, i përmendur tani e tutje si "Komiteti Ndërqeveritar", krijohet brenda UNESCO-s. Ai përbëhet nga përfaqësues të 18 shteteve palë të Konventës të zgjedhur për një mandat 4-vjeçar nga Konferenca e Palëve me hyrjen në fuqi të kësaj Konvente sipas nenit 29.

2. Komiteti Ndërqeveritar mbledhet çdo vit.

3. Komiteti Ndërqeveritar funksionon nën autoritetin dhe drejtimin e Konferencës së Palëve dhe përgjigjet para saj.

4. Anëtarët e Komitetit Ndërqeveritar do të bëhen 24 sapa numri i palëve të Konventës të bëhet 50.

5. Zgjedhja e anëtarëve të Komitetit Ndërqeveritar bazohet në parimet e përfaqësimit të drejtë gjeografik, si dhe të rotacionit.

6. Pa paragjykuar përgjegjësitë e tjera që i jepen nga kjo Konventë, funksionet e Komitetit Ndërqeveritar janë:

a) të zhvillojë objektivat e kësaj Konvente dhe të inkurajojë dhe monitorojë zbatimin e tyre;

b) të përgatisë dhe paraqesë për miratimin nga Konferenca e Palëve, me kërkesë të saj, udhëzimet funksionale për përmbushjen dhe zbatimin e dispozitave të Konventës;

c) t'i transmetojë Konferencës së Palëve raporte nga palët e Konventës, si dhe komente dhe një përmbledhje të përmbajtjes së tyre;

d) të bëjë rekomandimet e duhura që të merren parasysh në situata që sillen në vëmendje të tij nga palët e Konventës, në përputhje me dispozitat përkatëse të Konventës, në veçanti nenin 8;

e) të vendosë procedura dhe mekanizma të tjera për konsultim, që synojnë zhvillimin e objektivave dhe parimeve të kësaj Konvente në forume të tjera ndërkombëtare;

f) të kryejë detyra të tjera që mund të kërkohen nga Konferenca e Palëve.

7. Komiteti Ndërqeveritar në përputhje me rregulloren e brendshme, mund të ftojë në çdo kohë organizatat apo individët privatë ose publikë për të marrë pjesë në takimet e tij për konsultim mbi çështje specifike.

8. Komiteti Ndërqeveritar përgatitet dhe i paraqet për miratim Konferencës së Palëve rregulloren e tij të brendshme.

Neni 24

Sekretariati i UNESCO-s

1. Organet e Konventës ndihmohen nga Sekretariati i UNESCO-s.

2. Sekretariati përgatit dokumentacionet e Konferencës së Palëve dhe Komitetit Ndërqeveritar, si dhe rendin e ditës së mbledhjeve të tyre dhe ndihmon dhe raporton për zbatimin e vendimeve të tyre.

VII. KLAUZOLA PËRFUNDIMTARE

Neni 25

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Në rastin e një mosmarrëveshjeje ndërmjet Palëve të kësaj Konvente në lidhje me interpretimin ose zbatimin e Konventës, Palët kërkojnë një zgjidhje me anë të negocimit.

2. Nëse Palët e interesuara nuk mund të arrijnë një marrëveshje me anë të negocimit, ato mund të kërkojnë së bashku ndërhyrje, ose ndërmjetësim, të një pale të tretë.

3. Nëse ndërhyrja ose ndërmjetësimi nuk ndërmerren, ose nëse nuk arrihet zgjidhje me anë të negocimit, ndërhyrjes apo ndërmjetësimit, një Palë mund të bëjë rekurs për pajtimin në përputhje me procedurat e përcaktuara në Aneksin e kësaj Konvente. Palët konsiderojnë në mirëbesim propozimet e bëra nga Komisioni i Pajtitimit për zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

4. çdo Palë, në kohën e ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, mund të deklarojë që nuk e njeh procedurën e pajtitimit të parashikuar më lart. Secila Palë që ka bërë një deklaratë të tillë, në çdo kohë mund të tërheqë këtë deklaratë duke njoftuar Drejtorin e Përgjithshëm të UNESCO-s.

Neni 26

Ratifikimi, pranimi, miratimi apo aderimi nga Shtetet Anëtare

1. Kjo Konventë i nënshtrohet ratifikimit, pranimit, miratimit apo aderimit nga Shtetet Anëtare të UNESCO-s në përputhje me procedurat e tyre kushtetuese përkatëse.

2. Instrumentet e ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit depozitohen te Drejtori i Përgjithshëm i UNESCO-s.

Neni 27

Aderimi

1. Kjo Konventë është e hapur për aderim nga të gjitha shtetet joanëtare të UNESCO-s, por anëtare të Kombeve të Bashkuara ose të ndonjëres prej agjencive të saj të specializuara, që ftohen nga Konferenca e Përgjithshme e UNESCO-s për të aderuar në të.

2. Kjo Konventë është gjithashtu e hapur për aderim nga territoret që gëzojnë vetëqeverisje të plotë të brendshme të njohur si të tillë nga Kombet e Bashkuara, por që nuk kanë fituar pavarësinë e plotë në përputhje me Rezolutën 1514 të Asamblesë së Përgjithshme dhe që kanë kompetencë në çështjet e rregulluara nga kjo Konventë, duke përfshirë kompetencën për të marrë pjesë në traktate në lidhje me këto çështje.

3. Dispozitat e mëposhtme zbatohen për organizatat rajonale të integritit ekonomik:

a) Kjo Konventë është gjithashtu e hapur për aderim nga çdo organizatë rajonale për integritin ekonomik, që, përveçse si parashikohet më poshtë, janë krejtësisht të detyrueshme nga dispozitat e Konventës në të njëjtën mënyrë si Shtetet Palë;

b) Në rastin kur një ose më shumë Shtete Anëtare të një organizate të tillë janë gjithashtu Palë të kësaj Konvente, organizata dhe ky/këto Shtet/e Anëtar/e vendosin për përgjegjësinë e tyre për përmbushjen e detyrimeve të tyre sipas kësaj Konvente. Kjo shpërndarje e përgjegjësisë bëhet efektive pas përfundimit të procedurës së njoftimit të përshkruar në nënparagrafin (c). Organizata dhe Shtetet Anëtare nuk kanë të drejtë të ushtrojnë të drejta sipas kësaj Konvente njëkohësisht. Përveç kësaj, organizatat rajonale të integritit ekonomik, për çështje brenda kompetencës së tyre, ushtrojnë të drejtën e tyre për të votuar me një numër votash të barabartë me atë të Shteteve Anëtare që janë Palë të kësaj Konvente. Një organizatë e tillë nuk e ushtron të drejtën e votës nëse njëra nga Shtetet Anëtare të saj e ushtron të drejtën e vet dhe anasjelltas;

c) Një organizatë rajonale e integritit ekonomik dhe Shteti apo Shtetet e saj Anëtare të saj që kanë rënë dakord për një ndarje të përgjegjësisë si parashikohet në nënparagrafin (b) informon Palët për një ndarje të tillë të propozuar të përgjegjësisë në mënyrën e mëposhtme:

i) në instrumentin e tyre të aderimit, kjo organizatë deklaron me hollësi, ndarjen e përgjegjësisë të tyre, në lidhje me çështjet e rregulluara nga Konventa;

ii) në rastin e ndonjë ndryshimi të përgjegjësisë të tyre përkatëse, organizata rajonale e integritit ekonomik informon depozituesin për një ndryshim të tillë të propozuar të përgjegjësisë përkatëse; depozituesi nga ana e tij informon Palët për këtë ndryshim;

d) Shtetet Anëtare të një organizate rajonale të integritit ekonomik që bëhen palë të kësaj Konvente mendohet se vazhdojnë të ruajnë kompetencat mbi të gjitha çështjet në lidhje me të cilat transferimi i kompetencave tek organizata nuk është deklaruar në mënyrë specifike, ose nuk i është bërë i ditur depozituesit;

e) "Organizatë rajonale e integritit ekonomik" do të thotë një organizatë e përbërë nga Shtetet sovraane, anëtare të Kombeve të Bashkuara ose të ndonjë agjencie tjetër të specializuar të tyre, të cilëve këto Shtete u kanë transferuar kompetenca në lidhje me çështjet e rregulluara nga kjo Konventë dhe që janë autorizuar të bëhen palë e saj, në përputhje me procedurat e saj të brendshme.

4. Instrumenti i aderimit depozitohet te Drejtori i Përgjithshëm i UNESCO-s.

Neni 28

Pika e kontaktit

Secila Palë, kur bëhet Palë e kësaj Konvente, cakton një pikë kontakti si përmendet në nenin 9.

Neni 29

Hyrja në fuqi

1. Kjo Konventë hyn në fuqi tre muaj pas datës së depozitimit të instrumentit të 30-të të ratifikimit, pranimit, miratimit, apo aderimit, por vetëm në lidhje me ato shtete ose organizata rajonale të integritit ekonomik që i kanë depozituar instrumentet e tyre të ratifikimit, pranimit, miratimit apo aderimit atë ditë ose më përpara. Konventa hyn në fuqi në lidhje me çdo palë tjetër tre muaj pas depozitimit të instrumentit të saj të ratifikimit, pranimit, miratimit apo aderimit.

2. Për qëllimet e këtij neni, çdo instrument i depozituar nga një organizatë rajonale e integritit ekonomik nuk do të llogaritet si shtesë e atyre të depozituar nga Shtetet Anëtare të organizatës.

Neni 30

Sistemet kushtetuese federale ose jounitar

Duke pranuar që marrëveshjet ndërkombëtare i detyrojnë palët në të njëjtën mënyrë pavarësisht nga sistemet e tyre kushtetuese, dispozitat e mëposhtme zbatohen për palët që kanë një sistem kushtetues federal ose jounitar:

a) në lidhje me dispozitat e kësaj Konvente, zbatimi i së cilës bëhet sipas juridiksionit ligjor të pushtetit legjislativ federal apo qendror, detyrimet e qeverisjes federale apo qendrore do të jenë të njëjta me ato të palëve që nuk janë Shtetet federale;

b) në lidhje me dispozitat e Konventës, zbatimi i së cilës bëhet sipas juridiksionit të njëjësive përbërëse të veçanta si shtete, konte, provinca apo kantone të cilat sistemi kushtetues i federatës nuk i detyron të marrin masa legjislative, qeveria federale informon, kur është e nevojshme, autoritetet kompetente të njëjësive përbërëse si shtete, konte, provinca apo kantone të dispozitave në fjalë, me rekomandim për miratimin e tyre.

Neni 31

Denoncimi

1. Çdo Palë e kësaj Konvente mund të denoncojë këtë Konventë.
2. Denoncimi bëhet i ditur me anë të një instrumenti me shkrim të depozituar te Drejtori i Përgjithshëm i UNESCO-s.
3. Denoncimi hyn në fuqi 12 muaj pas marrjes së instrumentit të denoncimit. Denoncimi nuk ndikon në asnjë mënyrë në detyrimet financiare të Palës që denoncon Konventën deri në datën e hyrjes në fuqi të tërheqjes.

Neni 32

Funksionet e depozituesit

Drejtori i Përgjithshëm i UNESCO-s, si depozituesi i kësaj Konvente, njofton Shtetet Anëtare të organizatës, shtetet që nuk janë anëtare të organizatës dhe organizatat rajonale të integritit ekonomik të përmendura në nenin 27, si dhe Kombet e Bashkuara për depozitimin e të gjitha instrumenteve të ratifikimit, pranimit, miratimit apo aderimit të parashikuara në nenet 26 dhe 27 dhe për denoncimet e parashikuara në nenin 31.

Neni 33

Ndryshimet

1. Një Palë e kësaj Konvente, me anë të një njoftimi me shkrim drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm, mund të propozojë ndryshime të kësaj Konvente. Drejtori i Përgjithshëm e qarkullon këtë njoftim te të gjitha Palët. Nëse, brenda gjashtë muajsh nga data e dërgimit të njoftimit, jo më pak se gjysma e palëve përgjigjen në favor të kërkesës, Drejtori i Përgjithshëm e paraqet këtë propozim në sesionin e radhës të Konferencës së Palëve për diskutim dhe miratim të mundshëm.
2. Ndryshimet miratohen nga dy të tretat e shumicës së Palëve të pranishme dhe me votim.
3. Pas miratimit, ndryshimet e kësaj Konvente i paraqiten Palëve për ratifikim, pranim, miratim apo aderim.
4. Për Palët që kanë ratifikuar, pranuar, miratuar apo aderuar në to, ndryshimet e kësaj Konvente hyjnë në fuqi tre muaj pas depozitimit të instrumentit të përmendur në paragrafin 3 të këtij neni me dy të tretat e Palëve.

Pas kësaj, për çdo Palë që ratifikon, pranon, miraton apo aderon një ndryshim, ndryshimi në fjalë hyn në fuqi tre muaj pas depozitimit të instrumentit të ratifikimit, pranimit, miratimit apo aderimit.

5. Procedura e përcaktuar në paragrafët 3 dhe 4 nuk zbatohet për ndryshimet e nenit 23 në lidhje me numrin e anëtarëve të Komitetit Ndërqeveritar. Këto ndryshime hyjnë në fuqi në kohën e miratimit të tyre.

6. Një shtet ose një organizatë rajonale e integritit ekonomik e përmendur në nenin 27 që bëhet Palë e kësaj Konvente pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve në përputhje me paragrafin 4 të këtij neni, në mungesë të shprehjes së qëllimeve të ndryshme, konsiderohet të jetë:

a) Palë e kësaj Konvente të ndryshuar; dhe

b) Palë e një konvente të pandryshuar në lidhje me çdo palë që nuk detyrohet nga ndryshimet.

Neni 34

Tekste autentike

Kjo Konventë është hartuar në gjuhën angleze, arabe, franceze, kineze, ruse, spanjolle, ku të gjashtë tekstet janë njësoj autentike.

Neni 35

Regjistrimi

Në përputhje me nenin 102 të Kartës së Kombeve të Bashkuara, kjo Konventë regjistrohet në Sekretariatit e Kombeve të Bashkuara me kërkesë të Drejtorit të Përgjithshëm të UNESCO-s.

ANEKS

PROCEDURA E PAJTIMIT

Neni 1

Komisioni i Pajtit

Një Komision Pajtimi do të krijohet me kërkesë të njëres prej Palëve të mosmarrëveshjes. Komisioni, nëse Palët nuk bien dakord ndryshe, do të përbëhet nga pesë anëtarë, dy të emëruar nga çdo palë e interesuar dhe një president i zgjedhur bashkërisht nga këta anëtarë.

Neni 2

Anëtarët e Komisionit

Në mosmarrëveshje ndërmjet më shumë se dy palëve, Palët me të njëjtin interes emërojnë anëtarët e tyre të Komisionit me marrëveshje të përbashkët. Kur dy ose më shumë palë kanë interesa të ndryshme ose ekziston një mosmarrëveshje, nëse janë të të njëjtit interes, ata i emërojnë vetë anëtarët e tyre.

Neni 3

Emërimet

Nëse emërimet nga Palët nuk janë bërë brenda dy muajve nga data e kërkesës për të krijuar një Komision Pajtimi, Drejtori i Përgjithshëm i UNESCO-s i bën këto emërimet brenda një periudhe të mëtejshme dymujore, nëse kjo gjë kërkohet nga Palët që bëjnë kërkesën.

Neni 4
Presidenti i Komisionit

Nëse një President i Komisionit të Pajtitimit nuk zgjidhet brenda dy muajve të emërimit të fundit prej anëtarëve të Komisionit, Drejtori i Përgjithshëm i UNESCO-s cakton një president brenda një periudhe tjetër dymujore, nëse një Palë e kërkon këtë gjë.

Neni 5
Vendimet

Komisioni i Pajtitimit vendos me shumicë votash të anëtarëve të tij. Ai, nëse Palët nuk vendosin ndryshe, vendos për procedurën e vet. Komisioni jep një propozim për zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje të cilën Palët e konsiderojnë me mirëbesim.

Neni 6
Mosmarrëveshja

Mosmarrëveshja nëse Komisioni i Pajtitimit ka kompetenca do të vendoset nga Komisioni.

LIGJ
Nr. 9614, datë 21.9.2006

PËR CERTIFIKATAT ELEKTRONIKE TË GJENDJES GJYQËSORE

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1
Objekti

Ky ligj ka për objekt përcaktimin e rregullave për administrimin e regjistrit të gjendjes gjyqësore nëpërmjet rrugës elektronike.

Neni 2
Përkufizime

Në zbatim të këtij ligji, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

1. “Regjistër i gjendjes gjyqësore” është regjistri shkresor i gjendjes gjyqësore, regjistri themeltar elektronik i gjendjes gjyqësore dhe regjistri elektronik i gjendjes gjyqësore.

2. “Regjistër shkresor i gjendjes gjyqësore” është hedhja e të dhënave me shkrim në regjistër, sipas përcaktimeve të neneve 481 e në vazhdim të kreut III të Kodit të Procedurës Penale e që në vijim do të quhet “regjistri shkresor”.

3. “Regjistër themeltar elektronik i gjendjes gjyqësore” është banka elektronike e të dhënave për dënimet penale dhe rehabilitimin, të nxjerra në bazë të vendimeve penale të formës së prerë të gjykatave shqiptare, për shtetas shqiptarë, të huaj apo pa shtetësi, ku përpunohen të dhënat në mënyrë automatike dhe shkresore, duke garantuar ruajtjen, përpunimin dhe mosndërhyrjen në këtë sistem pa autorizimin përkatës. Regjistri i mësipërm nuk është *on-line* dhe në vijim do të quhet “regjistri themeltar elektronik”.

4. “Regjistër elektronik i gjendjes gjyqësore” është banka elektronike e të dhënave vetëm për faktin nëse personi është ose jo i dënuar. Këto të dhëna nxirren nga regjistri themeltar elektronik vetëm me ndërhyrjen e personit të autorizuar nga titullari i Zyrës. Ky regjistër në vijim do të quhet “regjistri elektronik”.

5. “Përpunim automatik i të dhënave” përfshin operacionet e hedhjes së të dhënave në regjistrin themeltar elektronik vetëm nga punonjësi i autorizuar, duke garantuar ruajtjen e të dhënave, kryerjen e veprimeve logjike dhe/ose aritmetike mbi këto të dhëna, marrjen e tyre nga institucionet përkatëse, gjykata e prokuroria dhe kalimin e këtyre të dhënave në regjistrin elektronik.

6. “Certifikatë elektronike e gjendjes gjyqësore” është vërtetimi i përfutur në rrugë elektronike nga regjistri elektronik i gjendjes gjyqësore, që vërteton se personi nuk është dënuar penalisht nga gjykatat shqiptare dhe në vijim do të quhet “certifikatë elektronike”.

7. “Certifikatë shkresore e gjendjes gjyqësore” është dokumenti i lëshuar nga “regjistri themeltar elektronik”, në mënyrë të shkruar, prej titullarit të Zyrës së Gjendjes Gjyqësore dhe që në vijim do të quhet “certifikatë shkresore”.

8. “Vetëdeklarim i personit” është deklarimi që bën personi përpara institucionit publik ose privat, shqiptar ose të huaj, për faktin nëse është apo jo i dënuar, i shoqëruar me autorizim me shkrim dhe me dokument identifikimi, për të lejuar institucionin të bëjë verifikimet e nevojshme.

9. “Formulari i vetëdeklarimit” është formulari i hartuar nga Ministria e Drejtësisë dhe i miratuar nga Këshilli i Ministrave, i cili përmban vetëdeklarimin, si dhe të dhënat e nevojshme për identifikimin e personit vetëdeklarues dhe që u shpërndahet institucioneve të autorizuar nga Këshilli i Ministrave.

Neni 3

Zyra e Gjendjes Gjyqësore

1. Zyra e Gjendjes Gjyqësore funksionon në Ministrinë e Drejtësisë. Organizimi dhe struktura e saj miratohen nga Ministri i Drejtësisë.

2. Zyra e Gjendjes Gjyqësore mban dhe përpunon të dhënat në regjistrin themeltar elektronik të gjendjes gjyqësore, në regjistrin elektronik të gjendjes gjyqësore, si dhe në regjistrin shkresor të gjendjes gjyqësore.

Neni 4

Përpunimi i të dhënave dhe mbrojtja e tyre

1. Përpunimi automatik i të dhënave në regjistrin themeltar elektronik dhe në regjistrin elektronik bëhet vetëm nga personi i autorizuar nga titullari i Zyrës së Gjendjes Gjyqësore.

2. Hedhja e të dhënave, ruajtja e tyre, kryerja e veprimeve logjike mbi këto të dhëna, mbrojtja nga ndryshimet, marrja dhe shpërndarja e tyre bëhen nëpërmjet niveleve të sigurisë, të përcaktuara nga një subjekt i licencuar në këtë fushë dhe nëpërmjet kodeve hyrëse, që administrohen vetëm nga titullari i Zyrës.

3. Shënimet dhe heqja e tyre në/nga regjistrat e gjendjes gjyqësore bëhen sipas përcaktimeve të Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale.

4. Titullarit të Zyrës i ndalohet t’u japë të dhëna të tretëve për nivelin e sigurisë.

Neni 5

Administrimi i regjistrit elektronik

1. Regjistri elektronik i gjendjes gjyqësore administrohet nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore.
2. Regjistri elektronik jep të dhëna vetëm për faktin nëse personi nuk është i dënuar. Ky regjistër nuk përmban të dhëna të detajuara për dënimet penale.
3. Titullari merr masat që regjistri elektronik të përditësohet çdo 24 orë.

Neni 6

Certifikatat elektronike

1. Certifikatat elektronike vërtetojnë se shtetasi nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë.
2. Shtetasit të dënuar me vendim të formës së prerë ose institucionit që kërkon informacion për të, sipas nenit 8 të këtij ligji, nuk i jepet certifikatë elektronike. Ai ka të drejtë të pajiset me certifikatë shkresore.

Neni 7

Vetëdeklarimi i gjendjes gjyqësore

1. Shtetasit e Republikës së Shqipërisë, si dhe shtetasit e huaj ose pa shtetësi lejohen të vërtetojnë gjendjen e tyre gjyqësore nëpërmjet vetëdeklarimit para institucioneve publike ose private, shqiptare apo të huaja, ku kërkohen të dhëna për gjendjen e tyre gjyqësore.
2. Vetëdeklarimi duhet të shoqërohet edhe me një autorizim të nënshkruar nga shtetasi, i cili autorizon këto institucione të verifikojnë gjendjen gjyqësore në regjistrin elektronik.
3. Vetëdeklarimi dhe autorizimi përbëjnë dokumente zyrtare dhe paraqitja në to i të dhënave të rreme dënohet sipas dispozitave të Kodit Penal.

Neni 8

Shpërndarja e certifikatave elektronike

1. Shpërndarja e certifikatave elektronike të regjistrit elektronik kryhet duke garantuar sigurinë e sistemit, të të dhënave dhe të fshehtësisë së të dhënave personale të shtetasve, nëpërmjet disa niveleve sigurie, sipas nenit 4 të këtij ligji.
2. Me vendim të Këshillit të Ministrave, institucioneve publike ose private, vendase apo të huaja, u jepet kodi i hyrjes dhe e drejta e marrjes së të dhënave në mënyrë të drejtpërdrejtë vetëm nga regjistri elektronik dhe jo nga regjistri themeltar, i cili nuk është *on-line*, duke garantuar teknikisht pamundësinë e manipulimit të regjistrit elektronik nëpërmjet sistemit elektronik *fingerprint*.
3. Institucionet publike ose private, vendase apo të huaja, që kanë të drejtën për të pasur akses në sistemin elektronik *fingerprint* mund të marrin certifikata elektronike në mënyrë të drejtpërdrejtë.
4. Institucionet e tjera, që nuk kanë të drejtë akses, sipas pikës 3 të këtij neni, kanë të drejtë të kërkojnë nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore informacionin përkatës me postë elektronike ose të zakonshme, kundrejt plotësimit të kërkesave të neneve të këtij ligji.
5. Titullari i Zyrës verifikon çdo 24 orë nëse marrja e këtyre të dhënave nga subjektet është bërë në përputhje me përcaktimet e këtij ligji.

Neni 9

Shpërndarja e certifikatave shkresore

1. Certifikatat shkresore përfitohen sipas përcaktimeve të nenit 484 të Kodit të Procedurës Penale.
2. Drejtuesit, inspektorët dhe specialistët e Ministrisë së Drejtësisë, për t'u këshilluar me të dhënat e regjistrit shkresor dhe me regjistrat elektronikë, duhet të kenë autorizim periodik ose të posaçëm nga Ministri i Drejtësisë ose nga zyrtari i ngarkuar prej tij. Për punonjësit e Zyrës, autorizimi lëshohet nga titullari i Zyrës së Regjistrit Gjyqësor.

Neni 10

Ndërhyrjet e paligjshme

1. Kur konstatohen ndërhyrje të paligjshme në regjistrin e gjendjes gjyqësore, duhet të njoftohen menjëherë organet kompetente.
2. Ndërhyrja e paligjshme në regjistrin e gjendjes gjyqësore ose në transmetimet kompjuterike dhe përhapja e të dhënave për gjendjen gjyqësore të personave nga punonjësit e autorizuar për përpunimin automatik të të dhënave, përbëjnë vepër penale dhe dënohen sipas dispozitave të Kodit Penal.

Neni 11

Nxjerrja e akteve nënligjore

1. Këshilli i Ministrave, brenda 15 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, përcakton subjektet që mund të paraqesin kërkesë për marrjen e certifikatës elektronike pranë Zyrës së Gjendjes Gjyqësore.
2. Ministri i Drejtësisë, brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, përcakton rregullat e hollësishme për marrjen e certifikatave në rrugë elektronike, sipas nenit 8 të këtij ligji.

Neni 12

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5063, datë 4.10.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

Abonimet vjetore mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi Zhan d'Ark, prapa ish-Ekspozitës "Shqipëria Sot", Tel: 042 555 63; ose 04 267 468
Çmimi i abonimit për Fletoret Zyrtare 2006 është 18 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

- | | |
|---|-------------|
| 1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË | |
| 2. KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR | |
| 3. REGJISTRAT E NOTERISË | |
| 4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI | |
| 1. PËR PROKURIMIN PUBLIK (2006) | 1500 |
| 2. PËR NËPUNËSIN CIVIL (2005) | 600 |
| 3. PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllim I-rë dhe vëllimi i II-të-2006)..... | 1500 |
| 4. PËR TAKSAT DHE TATIMET (+suplement 2006) | 1500 |
| 5. PËRMBLEDHËSE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT..... | 500 |

BOTIME TË REJA

- | | |
|--|-------------|
| 1. TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi I)..... | 1000 |
| 2. TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II)..... | 500 |
| 3. TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi I)..... | 1000 |
| 4. TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II)..... | 500 |
| 5. PËRMBLEDHJE MARRËVESHJESH NDËRKOMBËTARE NË FUSHËN E DREJTËSISË..... | 1000 |
| 6. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PUSHTETI VENDOR..... | 800 |
| 7. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NDËRTIMET..... | 500 |
| 8. PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË (2000-2006)..... | 1000 |
| 9. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SHOQËRITË TREGTARE..... | 500 |

Hyri në shtyp më 13.10.2006
Doli nga shtypi më 16.10.2006

Tirazhi: 4000 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja "Ilar"
Tiranë, 2006

Çmimi: 150 lekë